

**DISA REFLEKTIME MBI ORGANIZATËN BOTËRORE TË TREGTISË DHE
MEKANIZMAT MBROJTËS NË KUADËR TË SAJ**

Hyrje

Shqipëria u bë pjesë e Organizatës Botërore të Tregtisë (më poshtë OBT) në vitin 2000 pas zhvillimit të procesit të negocimit me vendet anëtare në OBT. Procesi i negocimit para anëtarësimit dhe më pas, procesi i zbatimit të angazhimeve ndaj OBT, janë shoqëruar me ndërmarrjen e reformave dhe rritjen standarteve, të domosdoshme për t'u përshtatur ndaj rrjedhave të sotme të tregtisë globale. Nismat e marra nga shteti shqiptar për të plotësuar angazhimet në kuadër të OBT-së po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme jo vetëm pse ndikojnë në zhvillimin ekonomik të vendit, por edhe sepse ato përbëjnë “kushte” për integrimin europian dhe atë rajonal. Aktualisht vihet re një ndërgjegjësim më i madh i grupeve të interesit për njohjen e angazhimeve që ka ndërmarrë shteti ynë ndaj OBT dhe për njohjen më nga afër të mënyrës së funksionimit të kësaj organizate. Ky ndërgjegjësim vjen dhe si rezultat i rritjes së efekteve që vijnë nga liberalizimi i tregut, të cilat, me fjalë më të thjeshta, mund të përmbledheshin në rritjen e konkurrencës, shkëmbin dhe ofrimin më të madh të produkteve dhe shërbimeve, të cilat prekin drejtpërdrejt intersat e biznesit vendas dhe të konsumatorit.

Lidhur me liberalizimin e tregtisë arrijtjet e sistemit të OBT-së shënohen ndër të tjera, nga përcaktimi ligjor që i bëhet veprimeve kundër liberalizuese, apo mbrojtëse, *si një përjashtim nga rregulli i përgjithshëm për tregti të lirë*; si dhe nga mundësia e përdorimit të këtyre mekanizmave vetëm në situata të caktuara në marrëveshjet e OBT-së. Ekzistenca e masave mbrojtëse shpesh është e lidhur me zbutjen e pasojave të dëmshme për industri të ndryshme, të ardhura kryesisht nga liberalizimi i tregut. Përdorimi i tyre në përputhje me rregullat e OBT-së i jep mundësi industrisë të rimëkëmbet dhe qeverisë të vazhdojë të gëzojë të njëjtën mbështetje në vend, pavarësisht nga nismat e marra.

Ndaj, për t'u ardhur në ndihmë të gjitha grupeve të interesit, është i nevojshëm sqarimi i rregullave dhe parimeve të kësaj organizate dhe i mekanizmave mbrojtës që ekzistojnë në kuadër të marrëveshjeve të saj. Duke njohur këto, kuptojmë dhe më shumë arsyet pse Shqipëria u bë anëtare në OBT, si edhe mundësinë e shfrytëzimit të hapësirave ligjore për mbrojtjen e biznesit vendas.

Artikulli do të ndahet në dy pjesë. E para do të fokusohet në arsyet që sollën lindjen e OBT-së, parimet dhe institucionet brenda saj, mekanizmin e zgjidhjes së konflikteve në OBT, si dhe llojet e detyrimeve dhe të drejtave që lindin për shtetet. Rëndësi do t'i jepet pranimit të një vendi në OBT, ku antarësimi i Shqipërisë, do të jetë një ilustrim i analizave teorike që do të përcillen në këtë punim. Ndërsa në pjesën e dytë do të analizojë mekanizmat mbrojtës që ekzistojnë në marrëveshjet e OBT/GATT, duke dhënë një tablo të përgjithshme të kushteve dhe mundësive konkrete të përdorimit të këtyre mekanizmave.

PJESA E PARË

I. Si lindi OBT-ja

1.1 GATT, pararendës i OBT

Idetë e hedhura me kohë për krijimin e institucioneve ekonomike ndërkombëtare të qëndrueshme kristalizohen në vitin 1944 e më tej. Dy momentet më të rëndësishme të asaj periudhe lidhen me; 1) krijimin i institucioneve ekonomike në sistemin e Bretton Woods¹ (Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtare); dhe 2) krijimin e Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat (më poshtë GATT). Duhet theksuar se GATT nuk i përket sistemit të Bretton Woods, por u krijua më vonë. Në atë periudhë (1946) u zhvilluan bisedime, për krijimin e një Organizate Ndërkombëtare për Tregtinë, (ITO), e cila do të plotësonte sistemin e institucioneve ekonomike të krijuara. Ndërsa dy të parat (FMN BB) do të adresonin problemet monetare dhe bankare, kjo e fundit do të mbulonte problemet e tregtisë, duke plotësuar kështu kuadrin institucional që lidhej me ekonominë botërore. Jo pa qëllim OBT-ja e krijuar më vonë u quajt si këmba e munguar e “stolit” të krijuar në sistemin e Bretton Woods-it.

Draft i parë i ITO-s u propozua nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës në 1946 dhe u pasua nga një sërë raundesh diskutimesh, ku më i fundit daton më 1948 në Havana. Ndërkohë bashkë me idenë e krijimit të ITO-s u ndërthur dhe ideja e krijimit të GATT, si pjesë integrale e saj. ITO do të përfshinte një traktat për krijimin e institucioneve ndërkombëtare për tregtinë, ndërsa në GATT do të përfshiheshin, së pari, negociimi për reduktim gradual të tarifave dhe, së dyti, një klauzolë e përgjithshme që lidhej me detyrimet tarifore. Përpjekjet e para për krijimin e kësaj organizate dështuan dhe ITO nuk hyri asnjëherë në fuqi. Dështimi erdhi më shumë si rezultat i mosmiratimit të saj në Kongresin Amerikan, ndërkohë që GATT vazhdoi të ekzistojë, si rezultati i vetëm i negociatave dhe të aplikohet nën disa kushte të veçanta².

GATT nuk hyri asnjëherë në fuqi si një traktat ndërkombëtar dhe aplikimi i tij u bë i mundur nëpërmjet Protokollit Provizor (PPA)³. Aplikimi i GATT nëpërmjet këtij protokollit parashikonte; 1) aplikimin e pjesës së parë dhe të tretë të GATT pa përjashtime; 2) aplikimin e pjesës së dytë, për sa kohë që kjo e fundit nuk binte ndesh me legjislacionin ekzistues të vendeve anëtare të GATT⁴. Pra, Palët Kontraktuese të GATT kishin të drejtën e të ashtuquajturës “grand father clause⁵”, e cila, në një farë mënyre, i

¹ Konferenca e Bretton Woods u mbajt më 1944 në SHBA, dhe adresonte zgjidhjen e shumë problemeve ekonomike të gjeneruara nga lufta dhe ato ekzistuese përpara Luftës së Dytë Botërore.

² Megjithëse SHBA ishte një nga ideatorët e kësaj marrëveshjeje, GATT 47 nuk u ratifikua asnjëherë në Kongresin Amerikan dhe SHBA e ratifikoi atë vetëm kur ratifikoi Marrëveshjen e Marrakeshit, që krijoi OBT-në. Ai mbeti vetëm një dokument i nëshkruar nga Presidenti Amerikan gjë që shqetësonte mjaft juristët e kohës për zbatimin praktik të tij në SHBA. Shih për më shumë: Raj Bhala “International Trade Law; Theory and Practice, Botimi i dytë, Lexis Nexis 2001, fq. 129

³ Shih: John H. Jackson “*The World trading system*” Law and policy of International Economic Relations” Botimi i dytë, MIT press, 2002. fq.39

⁴ Pjesa e parë e GATT i referohej tarifave MFN (parimi i kombit më të favorizuar) dhe pjesa e tretë ishte tërësisht procedurale. Pjesa e dytë kishte të bënte me detyrime të rëndësishme si procedurat doganore të kuotave dhe masave të tjera mbrojtëse.

⁵ “Grand father clause” ishte e drejta që u njihej Palëve Kontraktuese të GATT të devijonin nga detyrimet që rridhnin nga pjesa e dytë e tij kur ato binin ndesh me ligjet e brendshme ekzistuese.

bindi ata për të rënë dakord për ekzistencën e GATT. Një nga sukseset e OBT-së ishte pikërisht eliminimi i këtyre klauzoleve.

Megjithë vështirësitë e themelimit dhe aplikimit të tij nga pikpamja e së drejtës ndërkombëtare, GATT vazhdoi të ekzistojë për një kohë relativisht të gjatë dhe të shërbente si dokument bazë për raundet e negociatave lidhur me marrëdhëniet tregtare. GATT ofroi gjithashtu dhe një sistem zgjidhjeje konfliktesh, që ndonëse nuk ishte shumë i suksesshëm, ndihmoi në një farë mënyre në zbatimin praktik të kësaj marrëveshjeje.

1.2 Krijimi i OBT-së

Gjatë viteve të ekzistencës së GATT u zhvilluan tetë raunde të fokusuara kryesisht në reduktimin e tarifare dhe në diskutimin e çështjeve të tjera jo tarifore që lidheshin me tregtinë deri në krijimin e vetë OBT-së⁶. Raundi i Uruguajt (1986-1993) u pasua me nënshkrimin e Marrëveshjes së Marrakeshit, e cila sanksionoi dhe krijimin e vetë organizatës në 15 Prill të 1994. OBT-ja u krijua si një organizatë ndërkombëtare dhe marrëveshjet shumëpalëshe pjesë përbërëse e saj përfshinë më shumë sesa tregtia në produkte⁷. Për më tepër në kuadër të OBT-së u projektua mekanizmi më efikas i zgjidhjes së konflikteve, i cili nuk ishte hasur më parë nën ombrellën e organizmave ndërkombëtarë⁸.

Nga një vështrim i përgjithshëm, skema e traktateve të themeluara në Raundin e Uruguajt është: Trakti që krijoi OBT-në dhe tre Aneksat. Në aneksin I “Marrëveshja shumëpalëshe për tregtinë në mallra” përfshihen marrëveshjet e rëndësishme si GATT 94⁹ dhe Marrëveshjet Specifike¹⁰, Marrëveshja e Përgjithme për Tregtinë dhe Shërbimet (më poshtë GATS), dhe Marrëveshja mbi Aspektet Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale (më poshtë TRIPS). Në të dytin u përfshi Marrëveshja për Zgjidhjen e Konflikteve (më poshtë DSU) dhe në të tretin Mekanizmat e Rishikimit të Politikave Tregtare. Pranimi i këtyre traktateve si një “sigle undertaking”, pra si një “paketë e vetme”, shënon një hap të rëndësishëm të negociatave. Çmimi i futjes në OBT është

⁶ Raundet e GATT deri në krijimin e OBT-së janë: Raundi i Gjenevës 1940, Raundi i Annecy (1948-1949), Raundi i Torquay (1950-1951), Raundi i Gjenevës (1955-1956), Raundi i Dillon-it (1960-1962), Raundi i Kenedi-t (1964-1967), Raundi i Tokios (1973-1979), dhe Raundi i Uruguajt (1986-1994). Gjatë këtyre raundeve u vu re një rritje e numrit të shteteve anëtare, një përfshirje më e madhe e tregtisë botërore në vlerë dollari dhe negociatat u bënë më komplekse duke çuar në vështirësi për marrje vendimesh. Shih për më shumë për secilin raund: Raj Bhala supra note, 2, fq 132

⁷ Spektri i marrëveshjeve përfshiu dhe fusha të paprekura deri atëhere si shërbimet, pronësinë intelektuale, investimet e të tjerë.

⁸ Patricio Grane “*Remedies under WTO law*” Journal of International Economic Law 2001, fq. 755

⁹ Lidhja midis GATT-it aktual (94) dhe GATT-it 47 parashikohet në paragrafin 4 të nenit 2 të marrëveshjes që krijoi OBT-në. Të dyja marrëveshjet janë ligjërish të ndryshme dhe përmbajnë klauzola të ndryshme. Kjo do të thotë që GATT 49 nuk është pasues i GATT 47

¹⁰ Në Aneksin e 1A të Marrëveshjeve shumëpalëshe për mallra, përveç GATT 94, janë përfshirë dhe Marrëveshjet për Bujqësinë (AoA), Për masat Sanitare dhe Fitosanitare (SPS), për Barrierat Teknike në tregti (TBT), për masat mbi Tregtinë në Investime (TRIMS), për Rregullat e Origjinës së produkteve, për Licensat e Importit, për Antidampingun dhe Masat Mbrojtëse. Pjesë e këtij Aneksi janë dhe Memorandumet e Mirëkuptimit për Interpretimin e neneve ekzistuese të GATT 47 statusi juridik i të cilave është i paqartë. Për shumicën e vendeve anëtare ato përcaktojnë një obligim të përgjithshëm ose sqarim procedurash tashmë të aplikuara dhe të njohura nga vendet anëtare të OBT-së. Shih për më shumë J. Jackson, supra note 3, fq. 77

pikërisht anëtarësimi në marrëveshjen që krijoi OBT-në dhe marrëveshjet shumëpalëshe të përmendura më sipër¹¹. Paketa e vetme ligjore pranohet jo vetëm nga vendet anëtare në momentin e krijimit të OBT-së por dhe nga vendet që do të hyjnë më vonë¹².

Përveç marrëveshjeve plurilaterale¹³ të cilat janë opsionale, gjithçka tjetër është e detyrueshme për palët. Ky pranim i marrëveshjeve si një paketë e vetme, sjell disa vështirësi gjatë zbatimit praktik të tyre dhe konkretisht në rastet kur ato normojnë fusha të njejta.

Kështu shumë nene të GATT 47 janë plotësuar nga marrëveshje të veçanta¹⁴ të cilat në rast konflikti kanë përparësi mbi nenet e tij. Megjithatë pavarësisht nga ky rregull i përgjithshëm, duke ju referuar jurisprudencës së Jurisë dhe Trupit të Apelit në OBT, mund të themi që marrëdhëniet midis tyre karakterizohen nga: *konflikti, shmangie nga detyrimet, përsëritje dhe komplementariteti*¹⁵.

Në rastin e konflikteve midis marrëveshjeve që bëjnë pjesë në anekse të ndryshme, rregulli i ndjekur është që marrëveshjet sepcifike (*lex specialis*)¹⁶ të kenë prioritet për çështjet që lidhen me spektrin e tyre të rregullimit.

1.3 Institucionet kryesore të OBT

Për të forcuar parimin e mbizotërimit të ligjit dhe të rregullit në marrëdhëniet tregtarë brenda OBT-së, themeluesit e saj krijuan mekanizmat kushtetues për marrjen e vendimeve, përpunimin e agendave, drejtimin e liberalizimit të tregut, rishikimit të politikave tregtare dhe zgjidhjen e konflikteve.

Konferenca Ministrore është organi më i lartë vendim-marrës për të gjitha çështjet që lidhen me marrëveshjet, për pranimin e anëtarëve të rinj dhe për fillimin e raundeve tregtare. Ajo përbëhet nga përfaqësues të të gjithë vendeve anëtare¹⁷ dhe mbledhet të

¹¹ Christopher Arup “*The new World Trade Organization Agreements, Globalizing law through services and intellectual property*”, Cambridge University press, 2000, fq 47

¹² Lexo nenin II së bashku me nenin XII të marrëveshjes së OBT-së

¹³ Marrëveshjet Plurilaterale janë: Marrëveshja mbi Tregtinë e Avionëve Civilë, Marrëveshja mbi Prokurimet Publike, Marrëveshja Ndërkombëtare për Bulmetet, Marrëveshja Ndërkombëtare për Mishin dhe Gjedhin. Shqipëria ka aderuar në dy nga këto marrëveshje, në atë të Prokurimit Publik dhe atë mbi Tregtinë në Aviacionin Civil. Shih Protokollin e pranimin të Shqipërisë në OBT dhe Dokumentin e Grupit të Punës, W/T/ACC/ALB/53 dhe W/T/ACC/ALB/51

¹⁴ Bëhet fjalë për marrëveshjet e Antidumping, Masa Subvencionuese dhe Kundërvepruese, e Masave Mbrojtëse Emergjente e tjerë. Në marrëveshjen GATT 47 ato përmbledheshin në disa nene të veçanta, si neni IV, XIX, e tjerë.

¹⁵ Fryma e përgjithshme e institucioneve të OBT-së është që ti aplikojnë marrëveshjet në mënyrë kumulative dhe në këtë kontekst një ndihmë të veçantë jep dhe Konventa e Vjenës mbi Traktatet Ndërkombëtare 1969. Shih për më shumë për marrëdhëniet midis GATT dhe marrëveshjeve të tjera në aneksin e IA: Elisabetta Montaguti & Maurits Lugard: “*The GATT 1994 and other Annex 1^a Agreements: Four different relationships?*”, Journal of International Economic Law, 2000, fq.473-484

¹⁶ Për çështjet që kanë të bëjnë me pronësisë intelektuale TRIPs ka përparësi ndaj GATT pasi ky i pari është cilësuar si *lex specialis* nga Juria në çështjen India-Patent Protection for Pharmaceutical and Agricultural Chemical Products, WT/DS50/R. Shih për më shumë: Marc Bronkers: “The Exhaustion of Patent Rights under the WTO Law”, Journal of World Trade, 32(5), 1998, fq. 143

¹⁷ Neni IV:1 i Marrëveshjes që krijoi OBT-në

paktën një herë në 2 vjet¹⁸. Në intervalin e kohës midis dy konferencave, aktiviteti i organizatës udhëhiqet nga Këshilli i Përgjithshëm që përbëhet gjithashtu nga përfaqësues të shteteve anëtare. Nën varësinë e tij janë dy trupa të specializuar, Trupi i Rishikimit të Politikave Tregtare dhe Trupi i Zgjidhjes së Konfliktëve (më poshtë DSB) të cilët operojnë sipas procedurave përkatëse dhe përbehen nga përfaqësues të shteteve anëtarë. Lidhur me marrëveshjet e veçanta, OBT-ja parashikon një këshill të posaçëm për secilën marrëveshje, si Këshilli i Produkteve, i Shërbimeve dhe i Pronësisë Intelektuale. Konferenca Ministrorë është ngarkuar gjithashtu për krijimin e Komiteteve specifike, si Komiteti për Zhvillimin dhe Komiteti i Tregtisë dhe Ambientit. (shih aneksin I)

1.4 Parimet mbi të cilat funksionon sistemi tregtar i OBT-së

Duke qenë se marrëdhëniet tregtare janë komplekse dhe mbulojnë një fushë të madhe aktiviteteve dhe vendesh, është e rëndësishme të përcaktohen që në fillim disa parime që do të shërbejnë dhe si themele të qëndrueshmërisë të vete sistemit shumëpalësh tregtar. Ndaj dhe marrëveshjet e OBT-së janë të mbështetura dhe të qeverisura nga këto parime. Në vija të përgjithshme ato mund të përmbledhen në (1) Parimin e mosdiskriminimit dhe këtu futen : (A) Parimi i Kombit më të favorizuar dhe (B) Trajtimit Kombëtar, (2) Tregtia e lirë; e cila duhet të realizohet gradualisht nëpërmjet negociatave, (3) Parashikueshmëria; e cila realizohet nëpërmjet detyrueshmërisë¹⁹ dhe transparencës²⁰, (4) Promovimi i një konkurrence të drejtë (reciprociteti), (5) Inkurajimi i zhillimit dhe i reformave²¹. Secili nga këto parime gjen pasqyrim konkret në nenet e marrëveshjeve duke pasur një rëndësi të njëjtë zbatueshmërie. Megjithatë më poshtë do të fokusohem në disa prej tyre.

1.4.1 Parimi i Kombit më të Favorizuar

I pari detyrim që rrjedh nga antarësimi në OBT dhe në marrëveshjet përkatëse është ai i aplikimit të Kombit më të Favorizuar (MFN), në bazë të së cilit çdo vend anëtar në OBT duhet ti akordojë të gjithë vendeve të tjera anëtare, të njëjtin trajtim, privilegj, avantazh që i ka akorduar një vendi konkret për marrëdhëniet tregtare në mallra, për pronësinë intelektuale dhe për shërbimet²². Ky detyrim redukton në mënyrë progresive nivelin e diskriminimit midis vendeve në marrëdhëniet tregtare²³. Realizimi i këtij

¹⁸ Aktualisht që nga krijimi i OBT-së janë zhvilluar 5 Konferenca Ministrorë, Singaporit (1996), Gjenevë 1998, Seattle 1999, Doha 2001 dhe Kankun 2003. Doha shënoi hapjen e një Raundi të ri të rëndësishëm në arritjen e disa kompromiseve dhe Agenda e Zhvillimit e saj vazhdon të negociohet. Kankun nuk çoi asgjë përpara dhe palët vazhduan të mos bien dakord për shumë çështje, të cilat do të jenë dhe pjesë e diskutimit në një takim të ri në Gjenevë në 2005. Këtu mund të përmendim bujqësinë, “Çështjet e Singaporit ku futen konkurrenca dhe tregtia, investimet, transparenca, prokurimet publike”, pronësia intelektuale dhe industria.

¹⁹ Detyrueshmëria krijohet nga detyrimi për të mbajtur një nivel të caktuar të tarifave dhe për kuotat.

²⁰ Transparenca kërkon bërjen publike të normave dhe rregullave që lidhen me tregtinë dhe njoftimin e vazhdueshëm të OBT-së.

²¹ Understanding the WTO: Principle of the Trading System, në faqen e internetit të OBT-së, www.wto.org

²² Shih: Neni I i GATT 94 dhe Neni II i GATS, Neni 4 i TRIPs, të cilët përmbledhin të njëjtën terminologji.

²³ Parimi i Kombit më të Favorizuar përmbledh : Ndryshimin e tarifave dhe detyrimeve të tjera të zbatuara në marrëdhëniet tregtare, mënyrën e vendosjes së tyre, procedurat administrative në dogana, regjimin ligjor të shitjes transportimit shpërndarjes së produkteve dhe shërbimeve në një territor të caktuar, si dhe rregullat që mbulojnë pronësinë intelektuale, patentën dhe të drejtën e autorit.

detyrimi në vetvete mbështetet në parimet e “menjëhershmerisë”, dhe “pa kushte”, çka do të thotë që trajtimi jo diskriminues do t’u akordohet të gjitha vendeve në të njëjtën kohë, dhe nga ana tjetër, ky trajtim do t’u akordohet vendeve anëtarë të OBT-së pa pritur ndonjë përfitim në këmbim dhe pa kërkuar realizimin e ndonjë kushti konkret nga pala tjetër. Megjithatë përjashtime nga aplikimi i këtij parime bëhen ndër të tjera në dy raste : 1) Në krijimin e një bashkimi doganor dhe një zonë të tregtisë së lirë²⁴; 2) në marrëdhëniet preferenciale të vendosura midis një vendi të zhvilluar dhe një vendi në zhvillim²⁵.

1.4.2 Trajtimi Kombëtar (NT)

Ndërsa MFN lidhet me regjimin tregtar midis shteteve, shpesh i njohur si “normë e zbatuar në kufi”, Trajtimi Kombëtar, lidhet me regjimin tregtar brenda vendit. Ky parim sanksionon detyrimin e çdo shteti anëtarë të trajtojë njësoj si produktin dhe shërbimin vendas dhe atë të vendeve të tjera²⁶. Ky parim, ashtu si dhe ai i sipërpërmendur sanksionon dhe plotëson parimin e mosdiskriminimit në marrëdhëniet tregtare brenda dhe jashtë territorit të një shteti. Në bazë të këtij parimi, të gjitha taksat, rregullat dhe ligjet e një vendi, nuk duhet t’u akordojnë një trajtim më të favorshëm produkteve apo shërbimeve vendase me qëllim që të realizojnë mbrotjen e tyre përkundrejt prodhimeve po shërbimeve të huaja²⁷. Plotësimi i këtyre kritereve , pra i atij të *dhënies së favoreve* nga njëra anë dhe *qëllimi për mbrojtje* nga ana tjetër, përbën kusht për shkeljen e këtij parimi²⁸. Të dy elementët duhet të ekzistojnë *njëkohësisht*, ndaj shpesh është e vështirë vërtetimi praktik i tyre. Një ndihmë të madhe kanë dhënë Juria dhe Trupi i Apelit në OBT, në vërtetimin e tyre rast pas rasti, duke krijuar kështu një jurisprudencë të pasur.

1.4.3. Parimi i reciprocitetit

Parimi i reciprocitetit ka ekzistuar në marrëdhëniet tregtare që nga koha e GATT, dhe ai duhet kuptuar më shumë në një kontekst politik sesa juridik. Ky parim gjen zbatim më tepër në negociatat midis palëve dhe në disa raste ai është i sanksionuar dhe në vetë marrëveshje, si për shembull neni XXVIII i GATT, i cili parashikon zhvillimin e rinegociatave për reduktimin e tarifave në një reciprocitet midis palëve. Reciprociteti në kuptimin e hershëm të tij ka konsistuar kryesisht në balancat tregtare që lidheshin me tarifat. Por aktualisht në kushtet e një negocimi më të sofistikuar nga ana e shteteve

²⁴ Shih nenin XXIV të GATT 94. në bazë të këtij neni krijohen marrëveshjet e tretisë së lirë dhe bashkimi doganor. Devijim nga MFN realizohet nga zbatimi i tarifave shumë të ulta ose 0 vetëm për vendet që janë palë në këto marrëveshje, ose një regjim më i favorshëm për shërbimet për vendet palë në marrëveshje.

²⁵ Për shembull, Bashkimi Evropian i akordonte më parë një trajtim preferencial Shqipërisë në kuadër të Sistemit të Përgjithshëm Preferencial (GSP), i cili lejon zbatimin e tarifave shumë të ulta ose zero për produktet shqiptare të eksportuara në BE.

²⁶ Shih nenin III të GATT, nenin XVII i GATS dhe nenin 3 të TRIPS

²⁷ Tarifat janë të përjashtuara në këtë parim

²⁸ Neni III i GATT parashikon ndër të tjera se: Palët Kontraktuese pranojnë se taksat apo detyrimet e tjera nuk duhet të aplikohen në prodhimet e importuara apo të vendit me qëllim ruajtjen e prodhimit kombëtar.

anëtarë të OBT-së ai ndërthuret me parimin e një tregtie të ndershme “fair trade”²⁹, e cila përkthehet në një reciprocitet në aksesimin e tregjeve, e siguar kjo dhe me nxjerrje ligjesh dhe normash adekuate, në mënyrë që pala tjetër të realizojë këtë të drejtë.

1.5 Procesi i vendim-marrjes në OBT

OBT-ja është institucioni i vetëm i sistemit tregtar ndërkombëtar që lindi si rezultat i negocimit të vazhdueshëm të vendeve anëtare të saj. Në OBT, çdo shtet anëtar ka të drejtën e një vote³⁰. Në kundërshtim me organizata të tjera si FMN apo Banka Botërore, ajo nuk aplikon peshën në votim, si për shembull; përqindjen e peshës së një vendi në tregtinë botërore, apo kontributin e paguar. Pra, ajo parashikon mundësi të njëjtë votimi për të gjithë vendet, pavarësisht nga niveli i tyre ekonomik³¹. Zakonisht preferohet votimi maxhoritar për marrjen e një vendimi, por në rastet e çështjeve që kanë të bëjnë me GATT, shpesh është preferuar marrja e vendimeve me konsensus. Kjo parashikohet dhe në nenin IX të marrëveshjes që krijoi OBT-në. Ky është i vetmi nen që parashikon marrjen e vendimeve me konsensus, dhe prezumohet të shtrihet në të gjitha marrëveshjet e Raundit të Uruguajt, por ky mbetet veçse një interpretim. Nga ana tjetër, ideja e konsensusit mund ti japë të drejtën e vetos çdo shteti. Megjithatë duhet pranuar që nuk ka unanimitet në marrjen e vendimeve, shtetet jo prezente dhe ato që abstenojnë nuk mund të pengojnë marrjen e vendimeve me konsensus.

Vendimet e zakonshme merren me konsensus si në Konferencën Ministrore dhe në Këshillin e Përgjithshëm, dhe në rastet kur nuk arrihet konsensus, vendimet do të merren me votim maxhoritar të të gjithë të pranishmëve³². Interpretimit i marrëveshjes së OBT-së dhe anekseve të saj bëhet nga Konferenca Ministrore, dhe ai miratohet me $\frac{3}{4}$ e shteteve anëtare në OBT. Po në bazë të marrëveshjes së OBT-së, Konferenca Ministrore mund të votojë përjashtimin e një vendi nga një obligim i marrëveshjeve të Aneksit të I të marrëveshjes së OBT-së. Kërkesa për përjashtimin e përkohshëm nga obligimi i OBT-së bëhet pranë Këshillave përkatës. Për marrjen e një vendimi të tillë kur nuk arrihet konsensus, kërkohet $\frac{3}{4}$ e vendeve anëtare të OBT-së³³.

II. Zgjidhja e konflikteve

Pjesë e suksesit të Raundit të Uruguajt është dhe Memorandumi për Rregullat dhe Proçedurat që Drejtojnë Zgjidhjet e Mosmarrëveshjeve (më poshtë DSU), si pjesë

²⁹ Ky lloj reciprociteti është quajtur si reciprocitet agresiv nga shtetet individuale apo grupe shtetesh. Shih për më shumë Richard Senti dhe Patricia Conlan, World Trade Organization, 1997

³⁰ I vetmi përjashtim bëhet në rastin e BE, ku një votë ka Komuniteti Europian dhe nga një votë ka secili shtet antarë në BE, (15+1) vota.

³¹ Megjithatë është naive të thuhet se vendet më pak të zhvilluara kanë të njëjtën fuqi në vendimmarrje si vendet e zhvilluara. Për të balancuar këtë situatë vendet në zhvillim janë organizuar në grupe sipas interesave duke fuqizuar kështu imponimin në vendimmarrje në OBT. Shih: Who Controls the Loot?- Global Policy forum, në www.globalpolicy.org, 2002

³² Shih neni IX i OBT-së

³³ Neni IX: 3 i GATT

integrale e marrëveshjes që krijoi OBT-në. Mekanizmi i zgjidhjes së konflikteve i sanksionuar në këtë marrëveshje shënon arritje jo vetëm në terma absolut, domethënë në efikasitetin e treguar brenda sistemit të tregtisë ndërkombëtare, por dhe në terma krahasimor, duke i referuar kështu mekanizma të tjerë të zgjidhjes së konflikteve (si për shembull Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë). Karakteristikë thelbësore të tij është *detyrueshmëria për konformitet* e cila realizon një element të rëndësishëm të pa- ndeshur më parë nga ligjet ndërkombëtare: fuqinë detyruese³⁴. Suksesi i tij lidhet me sanksionimin e disa elementëve në nenin 3.2 të DSU, siç janë: *siguria dhe parashikueshmëria e marrëdhënieve shumëpalëshe tregtare, sigurimi i të drejtave dhe detyrimeve që lidhen me marrëveshjet për të gjitha palët, si dhe interpretimi i marrëveshjeve mbi bazën e normave të interpretimit të së drejtës ndërkombëtare*. Megjithatë, avantazhet e sjella nga ky sistem duke e krahasuar me sistemin e aplikuar në epokën e GATT-it, mund të përmbliidhen në:

- 1) Vendosjen e afateve dhe procedurave për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që nga konsultimet e deri në adoptimin e rekomandimit të Jurisë/Trupit të Apelit.
- 2) Krijimin i një Trupe Apeli i cili rishikon interpretimin ligjor që i bën marrëveshjeve Juria. Trupi i Apelit nuk mund të konsiderohet si gjykatë, ai përbën një mekanizëm quasi-gjyqësorë.
- 3) Adoptimin e menjëhershëm të rekomandimeve të Jurisë dhe Trupit të Apelit dhe dhënien e autorizimit për kundra përgjigje në rast se nuk arrihet konsensus për të adoptuar raportin.
- 4) Autoritetin e palës paditëse për të kërkuar autorizim për t'u kundërpërgjigjur dhe në sektorë që nuk janë objekt konflikti, në rastet kur nuk zbatohet raporti i Jurisë apo kur nuk arrihet një zgjidhje e kënaqshme e situatës³⁵.

Duke u nisur nga sa më sipër arrijmë në konkluzionin se OBT-ja sot konsiderohet si një organizatë me “dhëmbë”, por kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se, Juria apo Trupi i Apelit mund t'i imponohen një shteti që të ndryshojë apo shfuqizojë një ligj që shpallet në kundërshtim me ndonjë detyrim të marrëveshjes. Megjithatë, rekomandimet e tij ndiqen nga palët dhe detyrimi për konformitet krijon mundësinë e zgjidhjes së konfliktit pa kundrapërgjigje si një masë e parë në rast shkeljeje.

2. 1 Procedurat për zgjidhjen e konflikteve

Çdo vend anëtar në OBT duhet të njoftojë për nxjerrjen e një rregulli i cili prek një detyrim të marrëveshjeve³⁶. Ky njoftim në të shumtën e rasteve shoqërohet me konsultime të cilat janë të domosdoshme për zgjidhjen e problemeve që lindin nga zbatimi

³⁴ Chi Carmody “Remedies and conformity under the WTO Agreement. JIEL 5(2), 2002, 307

³⁵ Raj Bhala supra note 3, fq 219

³⁶ Bëhet fjalë për procedura normale notifikimi që lidhen më nxjerrjen e ndonjë mase sanitare, apo mase për kundërpërgjigje, subvencione, mbrojtje e të tjerë. Kjo është një kërkesë që përmbahet në të gjitha marrëveshjet e OBT-së. shih për shembull nenin 25 të Marrëveshjes lidhur me Subvencionet dhe Masat Kundërvepruese, apo neni X i GATT 47

i tij, pasi mund të ndodhë që ky rregull bie ndesh me marrëveshjet duke u shkaktuar dëme anëtarëve në OBT. Palët e interesuara duhet të përpiqen për një zgjidhje të kënaqshme të situatës³⁷.

Në rast se një konsultim i tillë nuk është i suksesshëm atëherë, pala e prekur mund të depozitojë një kërkesë për krijimin e Jurisë (në formën e një padie) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes³⁸. Një kërkesë e tillë mund të bëhet nga një shtet ose disa shtete së bashku.

Trupi i Jurisë caktohet nga Sekretariati i OBT-së dhe duhet të aprovohet nga palët në konflikt. Numri i antëreve të saj shkon nga tre deri në pesë kur palët e kërkojnë këtë të fundit. Ata zgjidhen nga fusha e tregtisë ndërkombëtare, juristë, ku një kujdes i veçantë i kushtohet konfliktit të interesave³⁹.

Pasi formohet Trupi i Jurisë zhvillohet seanca dëgjimore për pretendimet e palëve në proces dhe e palëve të treta. Mbarimi i seancës dëgjimore shoqërohet me paraqitjen e një raporti të ndërmjetëm nga ana e jurisë, me komentet dhe konkluzionet e tij. Dhe vetëm pasi palët kanë shprehur objeksionet apo sugjerimet e tyre shtesë për draftin e parë të rekomandimit, Juria bën raportin përfundimtar që i dërgohet DSB.

Raporti duhet të miratohet nga DSB-ja brenda një afati të caktuar për sa kohë që kjo e fundit bie dakord, apo pala e pakënaqur nuk apelon çështjen. Në qoftë se çështja shkon në apel, ajo dëgjohet nga tre nga shtatë anëtarët e e përhershëm të Trupit të Apelit të zgjedhur nga vetë DSB⁴⁰. Trupi i Apelit ka juridiksion vetëm për çështje që kanë të bëjnë më ligjin, dhe me interpretimin e marrëveshjeve dhe në këtë rast është i detyruar të ndjekë interpretimet e bëra nga Konferenca Ministrorë⁴¹. Raportet e Trupit të Apelit janë automatikisht të adoptueshme nga DSB përveç rasteve kur nuk arrihet konsensus për ti miratuar ato⁴².

Monitorimi i zbatimit të rekomandimit të Jurisë apo Trupit të Apelit për të sjellë rregullin, objekt i konfliktit me marrëveshjet e OBT-së, në përputhje me marrëveshjen respektive bëhet nga DSB. Në rast se shteti në fjalë nuk e sjell ligjin⁴³ në konformitet me rekomandimet e Jurisë dhe Trupit të Apelit, atëherë pala tjetër mund të kërkojë autorizimin nga DSB për kundërpërgjigje⁴⁴.

³⁷ Konsultimi është një kërkesë e domosdoshme e sanksionuar në DSU. Neni 4 i kësaj marrëveshjeje parashikon qëllimin dhe procedurat që duhet të ndiqen për konsultimin në mënyrë që të evitohet ngritja e padive.

³⁸ Shih nenin 6 të DSU. Principet mbi të cilat do të mbështet puna e tij gjatë zgjidhjes së konfliktit janë parashikuar në nenin 7 të DSU.

³⁹ Zakonisht nuk mund të caktohen si juri persona që kanë lidhje me shtetet në konflikt apo kanë një qëndrim të deklaruar për çështje që lidhen me marrëveshjet konkrete, shpesh në këtë nivel futen dhe akademikë dhe njerëz me njohuri në fushën e së drejtës tregtare ndërkombëtare të cilët kanë një qëndrim të hapur për një çështje. Sekretariati i OBT-së mban një listë të përhershme të jurisë. Në rast se shtetet palë në konflikt nuk bien dakord për trupin e Jurisë atëherë ai zgjidhet nga konsultimet midis Drejtorit të Përgjithshëm të OBT-së, drejtuesit të DSB dhe Kryetarit të Këshillit të marrëveshjes përkatëse. Shih nenin 8 të DSU në lidhje me krijimin e Panelit.

⁴⁰ Neni 17 i DSU

⁴¹ Shih nenin IX të Marrëveshjes së OBT-së

⁴² Neni 17 paragrafi 14 i DSU

⁴³ Sjellja e rregullit në përputhje me Rekomandimin mund të bëhet me amendim të ligjit ekzistues apo shfuqizimin plotësisht të tij. Trupat e gjyqimit mund të bëjnë sugjerime për mënyrën e sjelljes së situatës në përputhje me marrëveshjen, por kjo mbetet në kuadër të rekomandimeve vullnetare dhe jo të detyrueshme për zbatim nga ana e shteteve. Shih nenin 19 të DSU.

⁴⁴ Nenin 22.6 të DSU

Megjithatë një mundësi tjetër i ofrohet palës së pakënaqur nga zbatimi i rekomandimit, e cila pasi shterron mundësinë e konsultimit, kërkon përsëri krijimin e një Jurie të re për të shqyrtuar përputhjen e rregullit të rregullit të ri me rekomandimet e Jurisë apo Trupit të Apelit⁴⁵.

Nga një vështrim i përgjithshëm që i bëjmë sistemit të zgjidhjes së konflikteve në OBT, vëmë re se ai është i shoqëruar me negocime dhe këshillime të vazhdueshme dhe me një tendencë për zbatim të rezultateve të tij⁴⁶. Ky sistem unik kushtëzohet nga vetë natyra e marrëdhënieve tregtare të cilat mbartin në vetvete një interes të madh ekonomik. Në të shumtën e rasteve është e nevojshme të mbahen parasysh kushtet e veçanta që kanë disa vende dhe sektorët të cilat janë përfshirë në konflikt.

2.3 Llojet e të drejtave të përdorura në OBT

Sistemi i tregtisë shumëpalëshe është i bazuar ndër të tjera në konceptin e të drejtave dhe detyrimeve reciproke për palët të mbështetura në traktatet e OBT-së. Në rastet e shkeljes së këtyre detyrimeve apo të drejtave që rrjedhin nga marrëveshjet, çdo shtet anëtarë i OBT-së mund të kërkojë ndalimin e akteve nëpërmjet mekanizmit të zgjidhjes së konflikteve⁴⁷.

Mekanzmi aktual i ofruar nga OBT-ja parashikon në mënyrë eksplicite heqjen dorë nga aktet apo ligjet që janë në kundërshtim me marrëveshjen dhe sjelljen e situatës në përputhje me rekomandimet e dhëna nga trupat e zgjidhjes së konflikteve në OBT⁴⁸. Kjo e drejtë na çon në përfundimin se nocioni i restitimit, *status quo ante*, i njohur nga e drejta ndërkombëtare aplikohet deri diku në kontekstin e ligjeve të OBT-së. Pra e drejta e pretenduar në kuadër të OBT-së është *perspektive* dhe nuk synon të kthejë në gjendjen e mëparshme palët në konflikt, duke qenë kështu në përputhje të plotë me konceptimin e këtij mjeti në kuadër të së drejtës ndërkombëtare publike.

Neni 3 (7) i DSU parashikon në mënyrë hireakike të drejtat që mund të përdoren nga palët në mekanizmin e zgjidhjes së konflikteve.

Së pari, kërkohet heqja e masës e cila është në kundërshtim me një nen të marrëveshjes.

Së dyti, kërkohet kompensim, i cili realizohet vetëm kur shfuqizimi i ligjit praktikisht nuk është e mundur, ose kur shërben si masë e përkohshme, deri në shfuqizimin e ligjit jo konform marrëveshjes.

Së treti, vendi pretendues mund të pezullojë aplikimin e koncesioneve apo detyrime të tjera reciproke që rrjedhin nga marrëveshja pasi kjo është autorizuar nga DSB⁴⁹. Në rastet e pretendimeve pa shkelje të marrëveshjes⁵⁰, mjeti i parë i përdorur është kompensimi. Sheti që ka penguar arritjet e “kënaqshme” nga zbatimi i marrëveshjes

⁴⁵ Shih nenin 21. 5 të DSU dhe 22.2 , 22.6 të DSU. Gjatë zbatimit të kësaj procedure dhe nenit për autorizim për kundrapërgjigje është vënë re një konflikt në afatet e vendosura prej tyre, i cili ka krijuar të ashtuquajturin “Sequencing Problem” i ndeshur për herë të parë në çështjen e Bananeve, European Communities-Regime for the Importation, Sale and Distribution of Bananas, WT/DS27/AB/R, 1997

⁴⁶ Antonio Casses “ International Law” Oxford University Press 2001, fq.225

⁴⁷ Shih DSU të trajtuar më sipër

⁴⁸ Neni 19 i DSU

⁴⁹ Neni 3 (7) i DSU

⁵⁰ Shih nenin XXIII të GATT. Këtu bëhet fjalë për ato ligje të cilat nuk bien ndesh me marrëveshjet e OBT-së por pengojnë realizimin e të drejtave dhe përfitimeve të ofruar nga marrëveshjet.

nuk është i detyruar të shfuqizojë ligjin që ka sjellë këtë pengesë, por vetëm të kompensojë palën tjetër.

III. Shqipëria dhe OBT-ja

3.1 Procesi i antarësimit

Pak rregulla janë të sanksionuara në marrëveshjen e OBT-së për kushtet dhe mënyrën e pranimit të një vendi në OBT. OBT-ja, si shumë organizata të tjera ndërkombëtare, është e përbërë nga shtete të cilat e themeluan atë dhe nga shtete të cilat u antarësuan pas 1995⁵¹. Nga përmbajtja e nenit XII të marrëveshjes së OBT-së nuk kuptohet shumë se cilat janë kriteret dhe procedurat e hyrjes së një vendi në OBT, duke krijuar këtu një vakum ligjor për procesin e antarësimit. Antarësimi është i realizuar më shumë mbi bazën e rregullave të pashkruara dhe praktikisht janë krijuar precedentë të nevojshëm, për të sanksionuar mënyrën administrative të antarësimit.

Antarësimi zhvillohet me negocimin për “termat e hyrjes” midis vendit kandidat dhe OBT-së dhe këto terma janë të ndryshme për shtete të ndryshme, si rrjedhojë gjendja ekonomike e një shteti përcakton termat e hyrjes. Këto “terma” konsistojnë në një numër detyrimesh që rrjedhin nga marrëveshjet, si dhe në politika të përcaktuara tregtare që përmbahen në Protokollin e antarësimit të çdo shteti. Kushtet e negociuara lidhen pazgjidhmërisht me statusin me të cilin një vend hyn në OBT. Ky i fundit është i rëndësishëm, sepse ai kushtëzon periudhën tranzitore të zbatimit të marrëveshjeve të OBT-së. Kështu neni XIV i marrëveshjes së OBT-së parashikon se vendet të cilët kanë pranuar marrëveshjen e OBT-së, pasi ajo ka hyrë në fuqi, zbatojnë koncesionet dhe detyrimet e tjera pas një periudhe kohe, duke filluar që nga momenti i hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, sikur ata të kishin pranuar marrëveshjen që nga data e hyrjes së saj në fuqi⁵². Pra, si konkluzion një periudhë tranzitore është parashikuar për të gjitha vendet që bëhen anëtare të OBT-së.

Statusi i hyrjes është i lidhur gjithashtu dhe me mundësinë e përdorimit të klauzovalë të “Trajtimin Preferencial dhe të Diferencuar” që përcaktohen në marrëveshjet e OBT-së⁵³. Këto klauzola janë vënë në përdorim për vendet më pak të zhvilluara dhe

⁵¹ Që nga 1995 rrethe 47 vende kanë aplikuar dhe negociuar për tu bërë anëtarë të OBT-së dhe nga këto vende gjysma kanë qenë vende me ekonomi në tranzicion, shih: Marc Bacchetta dhe Zdenek Drabek: “Effects of WTO Accession on Policy Making in Sovereign States: *Preliminary lessons from the recent experience of transition countries*”, WTO Staff working Paper, 2002 fq. 2 në www.wto.org

⁵² Shih dhe ligjin e pranimit të Shqipërisë në OBT, Ligji nr. 8648, dt 28/7/2000

⁵³ Klauzolat e Trajtimin Preferencial dhe të Diferencuar janë përfshirë në marrëveshjet e OBT-së për vendet në zhvillim dhe më pak të zhvilluara për të arritur dy qëllime: së pari për të krijuar kushte të barabarta dhe konkurrencë të drejtë kur infrastruktura e vendeve është e ndryshme; së dyti për të mënjeluar deformimet e sjella nga fuqia negociuese e vendeve të zhvilluara. Këto trajtime konsistojnë në derogim të përkohshëm nga detyrimet e marrëveshjes, tarifa më të reduktuara për mallrat e këtyre vendeve, ulje të subvencioneve, përcaktimi i një baze për zbatimin e masave kundravepruese dhe fleksibilitet të kufizuar për detyrimet specifike. Megjithatë gjatë viteve të ekzistencës së OBT-së përdorimi i këtyre të drejtave nuk ka qenë i lehtë për kategoritë e përmendura, dhe përmbajtja e këtyre neneve është mjaft e kontestuar. Trajtimi S&D është

vendet në zhvillim, të cilët duhet të kualifikohen si të tillë që në momentin e anëtarësimit në OBT. Aktualisht në kuadër të OBT-së nuk ekziston ndonjë përkufizim për vendet në zhvillim, ato mund të vetë deklarohen të tillë në montetin e hyrjes në OBT dhe gjithçka është e varur nga termat e negociuara. Përsa i përket vendeve më pak të zhvilluara, situata është më e thjeshtë pasi ato njihen si të tillë nga Kombet e Bashkuara, të cilët posedojnë një listë për vende të tilla.

Procesi i hyrjes karakterizohet nga marrëdhënie asimetrike, pasi vendet që hyjnë në OBT, nuk mund të negociojnë më vendet ekzistuese përfitime të tjera shtesë, dhe vendet ekzistuese të OBT –së nuk kërkojnë më shumë sesa një status quo. Është vënë re që në të shumtën e rasteve vendet që kanë hyrë më vonë iu është kërkuar të ndërmarrin më shumë detyrime sesa vendet ekzistuese në OBT⁵⁴, pasi vetë organizata ka në themel të saj liberalizimin e vazhdueshëm të tregtisë.

3.2 Anëtarësimi i Shqipërisë në OBT

Shqipëria ashtu si dhe shumë shtete të tjera u bë antëtare me të drejta dhe detyrime të plota në OBT, pas dorëzimit dhe ratifikimit të protokollit të antarësimit në bazë të nenit XII të marrëveshjes së OBT-së⁵⁵. Protokollin është i shoqëruar me Raportin e Grupit të Punës⁵⁶ i cili përmban skedulin e angazhimeve për liberalizimin menjëhershëm dhe gradual të tarifave të produkteve dhe skedulin e liberalizimit të shërbimeve, zbatimin e standarteve për mbrojtjen pronësisë intelektuale dhe gjithashtu në këtë dokument përmbahen reforma që lidhen me privatizimin dhe një sërë masash të tjera që kanë të bëjnë me institucionalizimin e ekonomisë së tregut në Shqipëri.

Statusi me të cilin Shqipëria ka hyrë në OBT është ai vendit me ekonomi në tranzicion⁵⁷. Kjo vihet re dhe nga angazhimet që ka ndërmarrë ajo për reformat në privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore. Nga një vështrim i përgjithshëm që i bëhet Protokollit vihen re dy kategori detyrimesh. Të para janë në terma konkrete dhe konsistojnë në plotësim angazhimeve të llojit reduktim tarifash dhe liberalizim shërbimesh, të cilat do të realizohen duke zbatuar parimet e sipërpërmendura të OBT-së. Kategoria e dytë ka të bëjë me harmonizimin e ligjeve dhe sjelljen e tyre në përputhje me marrëveshjet e Raundit të Uruguajit. Marrëveshje të veçanta kërkojnë që kjo sjellje të jetë e vazhdueshme dhe Shqipëria duhet të njoftojë OBT-në sa herë që nxjerr apo amendon ndonjë ligj, që prek fushat që lidhen me to.

Detyrimet që ka ndërmarrë Shqipëria janë të pashmangshme për sa kohë ato lidhen me detyrimet e përcaktuara nga vetë marrëveshjet Për shembull: një ndryshim i tarifës më të lartë se ajo e përcaktuar në Protokollin e antarësimit do të përbentë një shkelje të nenit II:1 të GATT 94. Kjo do të jepte të drejtën çdo partneri tregtar me Shqipërinë të kërkonte ndryshimin apo heqjen e këtij ligji që sanksionon tarifën jo

pjesë e Agendës së Dohas për rinegociim dhe përmirësim, me qëllim përdorimin e tyre nga vendet më pak të zhvilluara. Shih: "Doha Round Briefing series, Special and Differential Treatment", ICTSD, Vol.1 No 13, Shkurt 2003

⁵⁴ Bernard M. Hoekman & Michel M. Kostecki " *The Political Economy of the World Trading System ; The WTO and Beyond*" Botimi i dytë , Oxford University Press 2001, fq 67

⁵⁵ Shqipëria ratifikoi Protokollin e pranimit në OBT me ligjin nr. 8648, dt 28/7/2000

⁵⁶ W/T/ACC/ALB/53 dhe W/T/ACC/ALB/41, në faqen e Internetit të OBT-së www.wto.org

⁵⁷ Marc Bacchetta dhe Zdenek Drabek, supra note 43

konform skedulit të angazhimeve, apo do ti jepte të drejtën për të kërkuar autorizim për kundërpërgjigje. E vetmja mënyrë për të devijuar nga detyrimet e marrëveshjeve është përdorimi i mekanizmave që ofrojnë vetë marrëveshjet për këtë qëllim⁵⁸.

Për të realizuar komunikimin e vazhdueshëm midis grupeve të ndryshme të interesit brenda vendit, dhe midis Shqipërisë dhe OBT-së, është ngritur i Sekretariati i OBT-së pranë Ministrisë së Ekonomisë. Përmes këtij organizmi Shqipëria realizon dhe një nga parimet e rëndësishme të OBT-së siç është ai i transparencës dhe njoftimit të vazhdueshëm.

Mbetet interesante të sqarohet se cili është statusi i vetë marrëveshjeve nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare në sistemin tonë të brendshëm. A mundet që nenet e marrëveshjes të invokohen në Gjykatat Shqiptare?

Së pari, mund të themi se marrëveshjet e OBT-së janë ratifikuar në bazë të neneve të Kushtetutës që mbulojnë ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare⁵⁹. Në bazë të nenit 122 të Kushtetutës, këto marrëveshje bëhen pjesë e sistemit tonë të brendshëm kur ratifikohen dhe botohen në fletoren zyrtare dhe ato janë direkt të zbatueshme në rastet kur përcaktojnë detyrime dhe të drejta eksplicite⁶⁰.

Zbatimi direkt i marrëveshjeve të OBT-së është pjesë e një debati të hapur dhe përcaktohet nga dy elementë: së pari nga lloji i sistemit në të cilin klasifikohet një vend; dualist apo monist⁶¹, dhe së dyti nga natyra e vetë marrëveshjes “efekti direkt” që kanë nenet e saj⁶². Neni 122 i Kushtetutës e kualifikon Shqipërinë si një sistem monist dhe si rrjedhojë nenet e marrëveshjeve të OBT-së, bëhen automatikisht pjesë e sistemit tonë të brendshëm pas ratifikimit dhe botimit në fletoren zyrtare.

Ndërsa elementi i dytë është i kushtëzuar dhe i huazuar nga përvoja e vendeve të tjera si BE apo SHBA për sa kohë që Gjykatat shqiptare nuk kanë bërë ndonjë interpretim të kësaj marrëveshje. Gjykatat e këtyre vendeve e kanë cilësuar GATT dhe marrëveshjet e tjera të OBT-së si marrëveshje jo direkt të aplikueshme⁶³. Kësaj linje arsyetimi i vjen në ndihmë fakti që këto marrëveshje i drejtohen shteteve dhe nuk gjenerojnë të drejta dhe detyrime për individët⁶⁴. Vetë sistemi i OBT-së apo marrëveshjet e saj nuk parashikojnë ezaurimin e sistemit të brendshëm gjyqësor para se një çështje të shkojë në Juri në OBT⁶⁵.

⁵⁸ GATT dhe marrëveshje të tjera të OBT-së lejojnë shmangiet e përkohshme nga detyrimet në situatë të përcaktuara ligjërish dhe në bazë të procedurave të ofruar nga marrëveshjet. Në çdo rast nuk duhet të humbasë balanca e një tregtie të lirë dhe kjo duhet të tregohet në çdo mekanizëm të përdorur.

⁵⁹ Protokolli i antarësimit në OBT u ratifikua në bazë të nenit 78, 83.1 dhe 121 të Kushtetutës së Shqipërisë.

⁶⁰ Neni 122 i Kushtetutës së Shqipërisë.

⁶¹ Sistemi monist kthen normën ndërkombëtare dhe e bën pjesë të normës së brendshme, vetëm nëpërmjet ratifikimit të marrëveshjes nga një organ kushtetues, ndërsa sistemi dualist e shikon atë si pjesë të veçantë nga normat e brendshme dhe ajo transformohet në ligj të brendshëm vetëm nëpërmjet mekanizmave të veçanta (siç mund të jetë nxjerra e ndonjë ligji) për zbatimin e normës ndërkombëtare në të drejtën e brendshme, nga çdo shtet sovran. Shih për shumë për sistemet: Cassese, supra note 45, fq.163

⁶² Shih për më shumë: John Jackson; “*Status of Treaties in domestic legal systems- A Policy Analysis*”, American Journal of International Law, 86,310, 1992

⁶³ Shih: Meinhard Hilf, “*The Role of National Courts in International Trade Relations*”, Michigan Journal of International Law, 18, 321, 1997, Vendimin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë në çështjen: Portugalia kundër Këshillit European, C-149/96, 1999

⁶⁴ Geert A Zonnekeyn “The Latest on Indirect Effect of the WTO Law in the EC Legal Order; The Nakajima case law Misjudged?” Journal of International Economic law (2002) 597-608

⁶⁵ Pavarësisht nga ky përfundim, është hedhur ideja nga shumë autorë që një invokim i ligjeve të OBT-së në sistemin e brendshëm do të forconte këtë të fundit. E vetmja arritje që mund të përmendet në këtë kontekst është vendimi i Gjykatës së Instancës së Parë të BE, në çështjet Cordis kundër Komisionit European T-

Pra, në rast se jurisprudenca e këtyre Gjykatave do të huazohej nga Gjykatat Shqiptare në kuadrin e të drejtave krahasuese, atëherë edhe në sistemin tonë të brendshëm marrëveshjet nuk do të ishin direkt të zbatueshme.

PJESA E DYTË

1. Vështrim i përgjithshëm mbi mekanizmat mbrojtës të OBT-së

Në përgjithësi marrëveshjet tregtare lejojnë mbrojtje dhe përjashtime të përgjithshme për disa detyrime që rrjedhin nga zbatimi i tyre. Kjo mundësi konsiston në njohjen e së drejtës së një qeverie apo një vendi për të hequr dorë përkohësisht, apo modifikuar një detyrim që rrjedh nga marrëveshjet tregtare, me qëllim që të mbrojnë prodhimin vendas.

Në Marrëveshjen e Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (më poshtë GATT), pjesë e marrëveshjeve të Raundit të Uruguajt⁶⁶, parashikohen mekanizma të tillë, të cilat ndonëse janë *një shkelle e hapur e tregtisë së lirë*, kanë qenë gjithmonë të pranueshme nga ana e palëve negociuese sepse kanë shërbyer si “*valvul shpëtuese*” për qeveritë e shteteve të ndryshme. Klauzolat e përmbajtura në marrëveshjen e OBT-së/GATT-it për mekanizmat mbrojtës dhe përjashtues ndahen në dy kategori kryesore⁶⁷:

- 1) Në grupin e parë futen ato mekanizma të cilat i referohen situatave të përcaktuara ligjërisht, dhe të cilat lejojnë një ngritje të përkohëshme të barrierave të importit⁶⁸. Në këtë grup bëhet dhe ndarja midis atyre situatave që quhen “unfair trade”, “tregti e pandershme” të cilat në të shumtën e rasteve janë subvencione për eksportin dhe grupi tjetër parashikon ato situata, të cilat jo domosdoshmërisht lidhen veprime që përbëjnë tregti të pandershme, si për shembull masat emergjente kundër ngritjes së importeve.
- 2) Në grupin e dytë parashikohen përjashtime nga detyrime të përgjithshme. Në këtë grup futen nenet që parashikojnë masa mbrojtëse për arsye morale, shëndeti publik, burimet natyrore etj. Masat e marra në këtë kontekst nuk duhet të jenë diskriminuese dhe nuk duhet të pengojnë tregtinë e lirë⁶⁹. Për shembull: Masa të marra për arsye të sigurisë kombëtare; si dhe mundësia e rinegocimit dhe modifikimit të skeduleve në rastet kur kompensimi është ofruar nga vendi që kërkon ta aplikojë këtë të drejtë.

18/99, Bocchi Food Trade International kundër Komisionit European, T-30/99, Mars 2001, e cila pranon rishikimin e rregullave evropiane nën dritën e normave të OBT-së. Shih: ibid, dhe Hilf, supra note. 62

⁶⁶ Raundi i Uruguajt u zhvillua 1986-1994

⁶⁷ Bernard M. Hoekman & Michel M. Kostecky “*The Political Economy of the World Trading System; the WTO and Beyond*” 2Ed. Oxford Press, 2001, fq. 303

⁶⁸ Këtu mund të përmendim: Anti duning, Masat Kundërvepruese, Masat për bilancin e pagesave, Mbrojtjen e industrive infante, Masat mbrojtëse specifike, etj.

⁶⁹ Shih nenin XX të GATT, paragrafët e këtij neni lexohen në përputhje me preambulën e tij e cila parashikon ndalimin e diskriminimit në masat që merren për ruajtjen e mjedisit apo jetës së njerëzve dhe që shoqërohen me kufizim të tregtisë

Fokusi i këtij punimi do të jetë një sqarim ligjor dhe praktik i disa prej këtyre mekanizmave⁷⁰. Një pjesë e mirë e tyre sot përfaqësohen nga marrëveshje të veçanta si ajo për antidumping apo masat mbrojtëse. Duke qenë se këto marrëveshje kanë një problematikë mjaft të zgjeruar dhe kërkojnë një studim të mirëfilltë, elaborimi i tyre do të jetë më i përgjithshëm. Përqëndrimi më i madh do të jetë tek nenet e GATT dhe referimet në marrëveshjet specifike do të bëhen në rast ndryshimesh apo për sqarime të mëtejshme.

Në përgjithësi këto mekanizma përdoren për mbrojtjen e industrive të veçanta dhe nga këto vetëm tre (bilancet tregtare, përjashtimet e përgjithshme dhe siguria kombëtare) kërkojnë një arsyetim më të gjerë ekonomik. Masat që i referohen industrive të veçanta mbështeten nga një kategori e caktuar argumenti dhe pretendimi, e cila lidhet kryesisht me mbrojtjen e firmave vendase nga konkurrenca e huaj.

1.1 Rinegociimi i koncesioneve (neni XXVIII i GATT)

Skeduli i koncesioneve bashkëngjitur Protokollit të pranimi të një vendi në OBT, përbën skedulin që i është bashkëngjitur si aneks marrëveshjes GATT 94⁷¹. Tarifat që përmbahen në këtë skedul janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga vendet anëtare dhe çdo ndryshim i tyre jo konform rregullave përbën një shkelje të nenin II:1 të GATT⁷².

Tarifat e detyrueshme mund të modifikohen ose tërhiqen vetëm në bazë të rregullave të caktuara në nenin XXVIII të GATT 94. Rinegociimi i tarifave është përdorur gati çdo vit gjatë së ekzistencë se GATT (1947-1995) dhe më rrallë në kuadër të OBT-së⁷³. Në jurisprudencën e GATT vetëm një çështje është sjellë para Jurisë në kuadër të paragrafit të dytë të këtij neni⁷⁴.

Principet bazë mbi të cilat realizohet modifikimi apo heqja e koncesioneve janë:

- 1) *kompensimi nga vendi që e kërkon diçka të tillë* (më poshtë do ti referohemi me emrin vendi aplikant) *duke liberalizuar produkte të tjera*;
- 2) *ruajtja e të njëjtit reciprocitet dhe avantazh të dyanshëm për koncesionet*, pra *ruajtja e të njëjtit trajtim të favorshëm për vendet e tjera*. (neni XXVIII: 2)⁷⁵

Paragrafët e nenit XXVIII përfshijnë në vija të përgjithshme:

- Periudhën e negociimit për heqjen apo modifikimin e koncesionit
- Vendet që janë përfshirë në negocie apo konsultime
- Veprimet që duhet të merren pas negociimit, kur një marrëveshje është arritur ose jo midis palëve

⁷⁰ Radha e vendosjes nuk bën ndonjë dallim për rëndësinë apo hirearkinë e këtyre neneve. Avantazhet dhe vështirësitë e zbatimit praktik do të paraqiten për të gjitha nenet e shtjelluara.

⁷¹ Neni i II: 7 i GATT 94

⁷² Neni II: 1 i GATT 94 parashikon se : Çdo palë kontraktore duhet ti akordojë palës tjetër në tregti trajtim jo më pak të favorshëm se ai i paraqitur në skedulin përkatës aneks të kësaj marrëveshjeje.

⁷³ Bernard M. Hoekman & Michel M. Kostecki, fq 309. Autorët e lidhin këtë fakt me riaktivimin e tarifave si rezultat i zbatimit të Sistemit të Harmonizuar nga ana e shteteve anëtare të OBT-së.

⁷⁴ Kanada-Tërheqje nga Koncesionet Tarifore- Raporti i Jurisë, L/4636-25S/42, 28 Prill 1978. Çështja kishte të bënte me rinegociimin për modifikimin e tarifave nga specifike në Ad valorem, për zingun dhe plumbin , midis Komunitetit Ekonomik Europian dhe Kanadasë. Kjo e fundit pretendonte se ky modifikim i tarifave përbënte shkelje të paragrafit 2 të nenit XXVIII të GATT.

⁷⁵ Shih: Udhëzuesin e notifikimeve tarifore në faqen e internetit të OBT-së: WT/TC/NOTIF/MA/1

Neni XXVIII i GATT përcakton të drejtën e vazhdueshme brenda afateve të caktuara të çdo shteti për të rinegociuar koncesionet, ndërkohë që neni XXVIII bis përcakton rregullat për një raund multilateral ku përfshihen të gjitha vendet për negocimin e tarifave.

Një periudhë tre vjeçare duke filluar që nga 1958 përbën dhe *periudhën ligjore* të rinegocimit të modifikimit të skeduleve apo tërheqjes së tyre. Në bazë të paragrafit të I të nenit XXVIII të GATT 94 dhe Ad Neni XXVIII, vendi aplikant duhet të njoftojë të gjitha vendet **për qëllimin e tij** të modifikimit dhe këtë duhet ta bëjë jo më vonë se 6 muaj dhe jo më herët se 3 muaj përpara përfundimit të periudhës ligjore, (psh: midis 1.7. 1987 dhe 30.9.87 përpara se një periudhë e re tre vjeçare të fillojë, për shembull 1 Janar 1988). Shqipëria mund ta shfrytëzonte këtë mundësi në fund të vitit 2003, në mënyrë që të reflektonte ndryshimet në Paketën Fiskale të 2004.

Pavarësisht nga kjo periudhë ligjore tre vjeçare, paragrafi 4 i nenit XXVIII i njeh të drejtën vendit aplikant të bëjë një kërkesë të tillë në çdo kohë, duke kërkuar një autorizim paraprak nga vendet anëtare pasi dorëzon këtë kërkesë Këshillit të Produkteve. Gjithashtu paragrafi i 5 i nenit përcakton se çdo shtet mund të rezervojë këtë të drejtë për periudhën e ardhshme ligjore, duke i notifikuar vendet përpara përfundimit të periudhës tre vjeçare të fundit.

1.1.1 Cfarë duhet të përmbajë notifikimi

Notifikimi duhet të përmbajë produktet dhe numrat përkatës të tarifës për të cilat kërkohet modifikim, si dhe vendet që kanë të drejtën e negociuesit të fillimit për këtë produkt. Duhet përcaktuar qartë nëse bëhet fjalë për modifikim apo heqje dorë nga një detyrim i marrë. Në qoftë se bëhet fjalë për modifikim atëherë ndryshimi i ofruar duhet paraqitet në notifikim, ose ti njoftohet sa më shpejtë të jetë e mundur palëve të interesuara. Statistikat e importit në një periudhë tre vjeçare për produktin në fjalë duhet ti bashkangjiten notifikimit. Në rast se vendi aplikant nuk paraqet statistika për importin, atëherë ai duhet të marrë në konsideratë statistikën e eksportit të ofruar nga palët e interesuara në këtë koncension. Nga data e vënies në dispozicion të statistikave vendet e tjera kanë 90 ditë në dispozicion të njoftojnë interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë rinegocim⁷⁶.

1.1.2. Vendet që marrin pjesë në rinegocim:

Sipas paragrafit të I të nenit XXVIII, vendi aplikant duhet të negociojë me :

a) vendet që ka negociuar që në fillim: këtu futen vendet me të cilat ka marrëveshje bilaterale dhe që janë të regjistruara në skedul, si dhe ato që kanë marrë pjesë në raundin negociues. Për sa i përket këtyre të fundit, vendet konsiderohen se kanë një të drejtë negociuese fillestare në qoftë se ato demonstrojnë një interes kryesor, i cili evidentohet nga marrja parasysh e një *periudhe të arsyeshme*. Kjo periudhë e arsyeshme llogaritet mbi shkëmbimet e tregtisë midis dy vendeve për tre vjet.

b) vendet që kanë një interes kryesor: konsiderohen ato vende që gjatë periudhës se arsyeshme, para rinegociatave kanë një përqëndrim më të madh të tregtisë në tregun e vendit aplikant, sesa vendet me të cilat është negociuar në fillim, ose do të kishin patur në mungesë të një diskriminimi nga kuotat. Kësaj kategorie mund ti shtohen dhe vende të

⁷⁶ ibid.,

cilat tregojnë një interes të madh, pasi ky produkt zë një vend të rëndësishëm në eksportin e tij.(Ad neni XXVIII:7) .

c) vendet që kanë një interes substancial: në të tillë kategori futen vende të cilat kanë, ose duhet të kishin në mungesë të një diskriminimi nga kufizimet sasiore një pjesë sinjifikante në tregun e vendit aplikant. Në praktikën e GATT, një 10 % e pjesës së tregut në vendin aplikant është njohur si rregull i përgjithshëm për ta klasifikuar vendin si furnizues substancial i vendit aplikant.

Çdo vend që mendon se ka një interes kryesor apo substancial në koncensionin në fjalë dhe që dëshiron të negociojë, duhet që në periudhën prej 90 ditësh pas shpërndarjes së statistikave, të komunikojë pretendimin e tij në formë të shkruar vendit aplikant dhe të informojë sekretariatin e OBT-së. Në qoftë se ky pretendim pranohet nga vendi aplikant atëherë vendi në fjalë merr pjesë në negociatë, në rast të kundërt vendi që ngre pretendimin duhet t'ja adresojë çështjen Këshillit.

1.1.3 Rezultatet e negociatave

Tre situata parashikohen si të mundshme të ndodhin pas negociatave:

- 1) Vendet me interes kryesor dhe substancial arrijnë një marrëveshje : vendet njoftohen për rezultatin dhe tarifa modifikohet. Negociatat duhet të përfundojnë para se tarifa e re të fillojë të aplikohet.
- 2) Vendet me interes kryesor arrijnë një marrëveshje, por vendet me interes substancial nuk janë dakord, këto të fundit janë të lirë që jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të marrëveshjes, të kundërveprojnë duke hequr një koncesion ekuivalent të negociuar që në fillim me vendin aplikant. (Neni XXVIII: 3 (b)).
- 3) Vendet me interes kryesor nuk mund të arrijnë një marrëveshje përpara mbarimit të afatit të periudhës ligjore të përcaktuar nga paragrafi I ; vendi aplikant është prap i lirë të tërheqë apo modifikojë koncesionin, por të gjitha vendet që ishin përfshirë në negociime apo konsultime janë gjithashtu të lejuar që jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të takimit të kundërpërgjigjen duke tërhequr një koncesion ekuivalent të negociuar që në fillim me vendin aplikant (XXVIII: 3(a))⁷⁷

1.1.4 Memorandumi i interpretimit të nenit XXVIII të GATT 94

Disa nga paragrafët e nenit XXVIII të GATT 47 janë diskutuar në Raundin e Uruguajit. Ato i referohen: a) përkufizimeve shtesë për vendet që kanë interes kryesor , b) nivelit të tregtisë midis vendeve të ndikuara, c) modifikimit për produktet e reja, d) zëvendësimit të tarifave me kuota tarifore e) dhënies së një të drejte për negociim fillestar.

a) **Vende me interes shtesë kryesor:** janë vendet që kanë një përqindje të lartë të eksportit të ndikuara nga ky koncension. Këto vende nuk janë pjesë e kategorisë së vendeve të parashikuara në paragrafin e II të nenit XXVIII. Qëllimi i shtimit të kësaj kategorie është të lejojë në negociim dhe vende me eksport të vogël ose të nivelit mesatar.

b) **Tregtia në bazë të tarifës MFN:** vetëm tregtia mbi bazën e tarifës MFN duhet të merret parasysh për të përcaktuar një vend me interes kryesor. Ky paragraf nuk do të aplikohet në rastet kur tregtia midis vendeve të përfshira është a) është rritur si rezultat i trajtimit preferencial ose b) do të bëhet e tillë pas mbylljes së rinegociatave.

⁷⁷ ibid.

- c) **Produktet e reja:** Kur një tarifë është tërhequr ose modifikuar në produktet për të cilat statistikën tre vjeçare mungojnë, e drejta e vendit negociator të fillimit i jepet vendit i cili i është dhënë kjo e drejtë kur janë përdorur klasifikimet e tjera: disa sqarime jepen dhe për vendet që kategorizohen në grupin e vendeve me interes substancial dhe kryesor.
- d) **Kuotat tarifore:** Kur një tarifë është zëvendësuar nga një kuotë, shuma e kompensimit duhet të kalojë sasinë e tregtisë të prekur nga ky zëvendësim, por nuk duhet të kalojë shumën e kompensimit të shkatuar nga heqja e plotë e koncesionit.
- e) **Vendet me të të drejtë të re rinegocuese-** vendi që ka një interes kryesor në koncesionin që është modifikuar, ose tërhequr, do ti njihet kjo e drejtë në koncesionin kompensues, derisa nuk është rënë dakord për ndonjë mënyrë tjetër kompensimi midis tyre.

Elementët e sqaruar më sipër duhet të përmbahen në dokumentin e notifikimit të çdo vendi që kërkon të rinegociojë tarifën. Nga një vështrim i përgjithshëm që i bëhet nenit mund të themi që konsultimet dhe vullneti politik midis palëve është ai që përcakton rezultatet e negociimeve. Në kushtet e Shqipërisë aplikimi i nenit ishte disi i vështirë, sepse në të shumtën e rasteve mungonin argumentat për statikat e mallrave, që kërkoreshin të mbroheshin dhe treguesit e importit për ato produkte nuk justifikonin mos liberalizimin e tarifave⁷⁸.

2. Përfshirja nga detyrimet e OBT-së dhe GATT-it (neni IX:3 i OBT-së dhe neni XXV:5 i GATT, Waiver-i)

Marrëveshjet e OBT-së dhe GATT-it lejojnë përfshirjen e një shteti nga detyrimet që rrjedhin prej tyre, por realizimi i kësaj mundësie është praktikisht i vështirë. Rregullat e dhënies së këtij përfshirjeje janë parashikuar në nenin XXV:5 të GATT dhe nenin IX:3 të marrëveshjes së OBT-së. Pavarësisht se neni IX:3 është më i detajuar, të dy nenet përcaktojnë të njëjtat kritere kryesore për dhënien e tij. Së pari ; përfshirja do të lejohet vetëm në **rrethana të veçanta** (exceptional circumstances) dhe së dyti: vetëm **kur aprovohet nga një supermajorancë** e anëtarëve të OBT-së (3/4 e anëtarëve).

Duhet theksuar fakti se nuk ka një përkufizim të gjerë se çdo të thotë rrethanë e veçantë në kuadër të nenit. Për më tepër nuk behet ndonjë referim te ndonjë nen tjetër i GATT apo në situata të diktuar nga nenet e marrëveshjeve të OBT-së në përgjithësi⁷⁹. Nga praktika e zbatimit të këtij neni është vënë re, se në të shumtën e rasteve përfshirja është bërë për marrëveshjet dypalëshe, që nuk kualifikoheshin në bazë të nenit XXIV⁸⁰ të GATT dhe që përbënin shkelje për nenet e tjera të GATT⁸¹.

⁷⁸ Shih të dhënat statistikore për birrën apo vajin në databazën e ACIT. www.acit-al.org

⁷⁹ Note on Waivers and Amendments në Raj Bhala: "International Trade Law: Theory and Practice", Lexis nexis, 2Ed. 2001, fq 580

⁸⁰ Neni XXIV i GATT përcakton kushtet dhe rregullat për krijimin e Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë dhe Bashkimeve Doganore.

⁸¹ Shih: Kërkesën e SHBA-së për rridhënien e përfshirimit për marrëveshjen e lidhur me Kanadanë për automobilat, Grupi i Punës i Këshillit të Mallrave United States-Imports of Automotive Products G/L/103, 4 /09/1996. Po kështu përfshirje është akorduar për marrëveshjen e partneritetit midis Komunitetit Europian dhe Vendeve Afrikane deri më 2007 për zbatimin e tarifave preferenciale për produktet që vijnë nga Vendet Afrikane në BE. Në të dyja rastet marrëveshjet përbënin shkelje të neni I të GATT, pra parimit të MFN.

Paragrafi i 4 i nenit IX të Marrëveshjes së OBT-së përcakton se, dhënia e kësaj preference duhet të justifikohet nga rrethanat e veçanta që e diktojnë atë dhe gjithashtu duhet të shoqërohet me kushtet dhe termat që e shoqërojnë këtë përjashtim. Zakonisht përjashtimi nga detyrimet jepet për një vit. Në rastet kur jepet më shumë sesa një vit duhet të shoqërohet me një rivlersim të situatës që e diktoi atë, në mënyrë që, të vlerësohet nëse rrethanat e veçanta ekzistojnë akoma dhe dhënia e këtij përjashtimi është i justifikuar.

Për sa i përket kërkesës për votim, neni XXV:5 i GATT parashikon dy situata të ndara:

- 1) Së pari palët kontraktore votojnë me 2/3 për ti lejuar të drejtën e përjashtimit nga detyrimet për vendin aplikant.
- 2) Së dyti kjo pjesëmarrje me 2/3 duhet të përfshijë më shumë se gjysmën e palëve kontraktore.

Në rastin e votimit të situatës së veçantë, domethënë kur palët mbledhen për të votuar nëse një situatë konkrete kualifikohet si e tillë apo jo, palët kontraktore mund të ndryshonin formulën e votimit. Por asnjëherë nuk duhet të shmangin bazën (threshold) prej 50+1.

Ky test ndarës votimi i parashikuar në GATT është ndryshuar nga neni IX:3 (a) i OBT-së, i cili parashikon vetëm votimin me $\frac{3}{4}$. Sipas këtij neni çdo përjashtim nga marrëveshjet shumëpalëshe (përfshirë këtu dhe GATT) duhet të miratohet me $\frac{3}{4}$ e anëtarëve të Konferencës Ministrore. Neni IX:3 (b), parashikon se fillimisht kërkesa për përjashtim nga detyrimet i bëhet Këshillit respektiv, si për shembull atij të produkteve, shërbimeve, apo të pronësisë intelektuale. Ky i fundit ia paraqet këtë kërkesë Konferencës Ministrore brenda 90 ditëve. Konferenca përcakton nëse ekzistojnë rrethana të veçanta që e justifikojnë masën e marrë, kushte dhe termat që duhen ti bashkëngjiten asaj, si dhe ri-vlersimin e situatës në rast se kërkohet shtyerje e përjashtimit apo heqje e tij. Në të gjitha këto etapa Konferenca luan të njëjtin rol që luante Këshilli i mallrave të GATT përpara ekzistencës së OBT-së.

Për aspekte të ndryshme OBT-ja kërkon kalimin e barrës së provës për vendin që e kërkon përjashtimin. Në shumë raste përjashtimi mund të konsistojë në zgjatjen e një periudhe për zbatimin e një detyrimi apo të një periudhe tranzitore, dhe në këtë kontekst shumë nga marrëveshjet e OBT-së përmbajnë nene të trajtimit special dhe të diferencuar (S&D) për vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara Përdorimi i këtyre neneve është më i lehtë, sepse kërkon një konsensus të thjeshtë për zgjatjen e periudhës tranzitore⁸², ndërkohë që, përjashtimi (waiver-i) kërkon një votim me $\frac{3}{4}$, gjë që është e vështirë të arrihet praktikisht. Ndaj shpesh vendet anëtare të OBT-së në pamundësi të përdorimit të neneve S&D, janë të detyruar të plotësojnë politikisht dhe ekonomikisht detyrimet e vështira që përmbahen në marrëveshje⁸³. Shqipëria e ka invokuar këtë nen (IX:3 i OBT-së) për shtyerjen e afateve lidhur me liberalizimin e Telekomit në fund të vitit 2003.

3. Masat emergjente kundra importit të produkteve të veçanta (neni XIX i GATT dhe Marrëveshja e Masave Mbrojtëse, Safeguard Agreement)

⁸² Shih për shembull nenet 65, 66 të TRIPs-it (Marrëveshja e Aspekteve Tregtare të të Drejtave të Pronësisë Intelektuale)

⁸³ shih : Bahla "Internacional Trade Law and theory" fq. 579

3.1 Arsyet historike dhe ekonomike të ekzistencës së masave mbrojtëse

Ekzistenca e një klauzole për shmangie nga detyrimet që rrjedhin nga tregtia e lirë ka datuar dhe para ekzistencës së nenit XIX në GATT. Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë të parët që e kanë përdorur një klauzolë të tillë në vitet 1943 dhe më pas Presidenti Truman nxorri një akt në të cilin përcaktohej se, një klauzolë e tillë duhet të përmbahej në të gjitha marrëveshjet tregtare që lidhte Amerika⁸⁴. Më vonë kjo klauzolë u emërtuar “Masat emergjente kundra importit të produkteve të veçanta” dhe u parashikua në nenin XIX të GATT 47. Megjithatë akoma nuk është e qartë arsyeja e pasjes së një klauzole të tillë dhe në GATT. Shumë skeptikë të këtij neni e quajnë atë si një kundërshtim i frymës liberale dhe konkurruese të tregtisë që parashikon GATT. Pavarsisht nga ky qëndrim ekzistojnë të paktën 4 argumenta pro ekzistencës së kësaj klauzole⁸⁵ dhe ato janë:

1) Rivendosja e kushteve të konkurrueshmërisë

Masat e vendosura në kuadër të nenit XIX i japin mundësi industrisë së dëmtuar të rimarrë veten dhe ti përshtatet përsëri kushteve të konkurrencës. Me anë të kësaj kohe dhe këtyre masave i jepet mundësi industrisë të rigjenerojë të ardhura dhe të maksimizojë fitmimin. Komuniteti tregtar ndërkombëtar dhe veçanërisht konsumatorët nuk përfitojnë nga kjo e situatë.

2) Rishpërndarja e kostove

Neni XIX është një mjet për shpërndarjen e kostove dhe axhustimin e tregut. Duke qenë se prodhuesit vendas ndeshen me një produkt importi kompetitiv, atëherë ata janë të detyruar të hidhen në prodhimin e produkteve kompetitive për importin, dhe një fenomen i tillë shoqërohet me ri axhustim të faktorëve punëtor, kapital human, kapital fizik etj.

3) Valvul shpëtuese politike

Në një situatë të tillë kur një nga industritë dëmtohet nga rritja e importit ekzistenca e kësaj klauzole i jep shansin qeverisë të marrë të gjitha masat për ta mbrojtur atë. Në mungesë të saj presioni mbi qeverinë do ta çonte këtë të fundit të merrte masa dhe më mbrojtëse për prodhimin vendas, të cilat mund të përbënin shkelje të rregullave të OBT-së.

4) Teoria e zgjedhjes publike

Kjo klauzolë i ka shtyrë vendet anëtare të OBT-së dhe konkretisht anëtarë të GATT të marrin pjesë në më shumë koncesione detyruese, gjë që nuk mund të realizohej në mungesë të kësaj klauzole. Kjo teori nuk është gjë tjetër veçse aplikimi i instrumentave makroekonomikë në sjelljen politike. Neni XIX në këtë kontekst i autorizon politik-bërësit të fokusohen më shumë tek nevojat e një industrie të dëmtuar. Ai shërben si një çelës për të rregulluar trade off midis liberlazimit të tregut, të krijuar gjatë nënshkrimit të marrëveshjes dhe mundësisë për t’u mbrojtur pasi marrëveshja ka hyri në fuqi. Pra në një farë mënyrë ekzistenca e kësaj klauzole i jep dorë politikbërësve të shmangin “frikën” që vjen si pasojë e marrjes përsipër të detyrimeve të shumta dhe detyrimeve tarifore. Si konkluzion, ekzistenca e kësaj klauzole krijon kushte për

⁸⁴ ibid., fq 1118

⁸⁵ ibid.,

akomodimin e intersave të shteteve anëtare të OBT-së, brenda interesave e natyrës së vetë marrëveshjes.

3.2. Masat emergjente kundër importit dhe neni XIX i GATT-it

Në kuadër të neneve që lejojnë shmangie apo mbrojtje të përkohshme nga detyrimet që rrjedhin nga GATT është dhe neni XIX i GATT i cili lejon marrjen e disa maseve (të quajtura dhe masa mbrojtëse) kundër importit të një produkti, kur mendohet se është dëmtuar industria vendase, me qëllim për ta **ri-axhustuar atë, në mënyrë që të rimëkëmbet.**

Dëmtimi i kësaj industrie duhet të vij nga një efekt i drejtpërdrejt që shkaktohet nga ngritja e importit dhe nuk është e nevojshme të demonstrohet se importet janë dump apo janë të subvencionuara në shtetet përkatëse. Raundi i Uruguajt solli dhe krijimin e “Marrëveshjes për Masat Mbrojtëse” e cila shpjegon dhe elaboron në mënyrë më të plotë nenin XIX të GATT. Në rast konflikti midis nenit XIX të GATT-it dhe një neni të marrëveshjes në fjalë, kjo e fundit ka përparësi.

Neni XIX dhe marrëveshja kërkojnë që, në rast se një *situatë e paparashikuar* ndodh në një vend anëtarë dhe *shkakton dëmtim të produktit të ngjashëm vendas dhe atij direkt konkurrues*, atëherë ky vend *merr masa mbrojtëse* duke pezulluar obligimin në tërësi ose duke hequr apo modifikuar koncesionet tarifore.

Lidhur me fjalën “zhvillim i paparashikuar” Trupi i Apelit në OBT ka dhënë në çështjen Argentina Footwear⁸⁶ dhe Korea-Dairy⁸⁷ një sqarim më të hollësishëm se çfarë nënkuptohet me këtë term. Marrëveshja e masave mbrojtëse nuk përmban asnjë përkufizim për këtë situatë, i vetmi sqarim jepet deri diku në nenin XIX:1(a). Duke iu referuar kuptimit të vete fjalës “i paparashikuar”, TA e parashikon këtë situatë si të pa pritur për palën dhe si rrjedhojë, rritja e nivelit të importeve shkon deri në atë masë, sa të dëmtojë industrinë vendase . ***Pra situata duhet të jetë e papritur dhe kushtet që e diktuan atë të plotësojnë kërkesat e nenit 2.1 të marrëveshjes për masat mbrojtëse dhe këto kërkesa janë: 1)produkti është importuar në atë masë dhe në ato kushte; 2) të cilat shkaktojnë ;3)një dëmtim serioz ose kërcënim për dëmtim serioz të industrisë vendase.*** Marrëveshja e Masave Mbrojtëse në OBT kërkon që vendet anëtare mund të aplikojnë një masë mbrojtëse vetëm pas kryerjes së një investigimi nga autoriteti përkatës dhe ta bëjnë atë publike sipas kërkesave të neni X të GATT 94.

3.3 Një vështrim i përgjithshëm për Marrëveshjen e Masave Mbrojtëse të OBT-së (Safeguard Agreement)

- Siç dhe e thamë dhe më lartë një masë mbrojtëse aplikohet kur ndodhemi në kushtet e nenit XIX të GATT. Masat nuk duhen të jenë diskriminuese për vendet, përveç rasteve kur ka marrëdhënie preferenciale dhe përveç rasteve kur vendosen kuota të cilat tregojnë se importet më të mëdha vijnë nga një vend i caktuar.
- Masat duhet të vendosen pas një hetimi të plotë nga një autoritet publik kompetent, hetim i cili nis me kërkesë të ndërmarrjeve produkti i të cilave është dëmtuar

⁸⁶ Argentina-Safeguard Measures on Imports of footwear , W/T/DS121/AB/R i adoptuar në 14 / 12/ 1999

⁸⁷ Korea-Safeguard Measures on Imports of Certain Dairy Products, W/T/DS98/AB/R 14 /12/ 1999

nga ky import. Njoftimi duhet të bëhet për të gjitha grupet e interesuara dhe këtyre të fundit gjithashtu duhet t'ju jepet mundësia të japin mendimin e tyre.

- “Dëmtimi serioz”, ose “kërcënimi për dëmtim serioz” i industrisë duhet të vlerësohet gjatë hetimit kur ky dëmtim është bërë evident.

- Duhet të demonstronhet se rritja e importit ka shkatuar dëmtime serioze. Dhe për më tepër në qoftë se faktorë të tjerë ndryshe nga rritja e importit kanë shkaktuar dëmtime, këto faktorë nuk duhet të merren parasysh.

- Masat mbrojtëse nëse aplikohet duhet të mbrojnë apo të parandalojnë dëmtimin serioz që i atribuohet vetëm rritjes së importit dhe lehtësojnë rimëkëmbjen e industrisë vendase. Masat duhet të liberalizohen në mënyrë rritëse Këto masa përfshijnë kufizime tarifore dhe sasiore.

- Masat mbrojtëse janë të limituar në 4 vjet, por mund të shtyhen deri në 8 vjet dhe vendi aplikant duhet të provojë se industria është akoma e dëmtuar dhe ka akoma nevojë të rimëkëmbet.

- Në qoftë se masa është aplikuar për më shumë se 3 vjet, atëherë ajo duhet rishikuar dhe në qoftë se është mundur ajo mund të hiqet ose të liberalizohet në mënyrë të përsheptuar.

- Vendi që aplikon një masë të tillë, duhet të demonstrojë se mban në mënyrë substanciale një nivel ekuivalent koncensionit dhe detyimesh me vendin i cili preket nga ky kufizim eksporti. Vendet në fjalë mund të bien dakord për kompensim. Dhe në rast se nuk arrihet një marrëveshje, vendi eksportues mund të kundërpërgjigjet në mënyrë të njëanshme. Megjithatë kjo e drejtë përdoret nga vendet të cilat preken nga masat mbrojtëse për tre vjet, ose kjo masë është përdorur kundra importit të cilat janë ngritur në terma relativë, por jo në terma absolutë⁸⁸ ndaj produktit vendas.

- Masat mbrojtëse nuk mund të aplikohen kundra importit nga vendet në zhvillim derisa pjesa e tij e importit përbën 3% të totalit të importit, ose importi nga vendet në zhvillim si i tërë përbën 9% të të gjitha importeve.

Kjo marrëveshje ka gjetur aplikim të gjerë në kuadër të OBT-së. Megjithatë në situatën e Shqipërisë nuk mund të invokohet, pasi vendi ynë ka pranuar mos zbatimin e saj, për sa kohë mungon kuadri legjislativ i brendshëm⁸⁹. Ndaj si rrjedhojë lind nevoja për nxjerrjen e një ligji i cili mundëson aplikimin e masave mbrojtëse, gjë që do të mundësonte biznesin vendas të kërkonte nisjen e hetimeve në rast dëmtimesh serioze nga rritja e importit.

4. Asistencë qeveritare për zhvillim ekonomik (neni XVIII i GATT 1994)

Neni XVIII i GATT është futur në kategorinë e atyre neneve që krijojnë **trajtime speciale dhe të vençanta për vendet në zhvillim dhe vendet më pak të zhvilluara**. Ky argument nuk del shumë nga përmbajtja e nenit, por nga shpjegimet dhe argumentimet që bëhen mbi ekzistencën e tij. Ky nen lejon ndër të tjera modifikimin apo heqjen e

⁸⁸ Rritja absolute dhe ajo relative përcaktojnë dy situata të ndryshme të cilat nuk bashkëekzistojnë domosdoshmërisht. Kështu në rritjen absolute mund të ndodhë kur rriten eksportet në vendin importues, pa patur domosdoshmërisht një rritje të prodhimit vendas. Ndërsa në rritjen relative, megjithëse importi nuk është rritur shumë, përsëri në raport me prodhimin vendas shënon rritje, sepse ky i fundit është ulur.

⁸⁹ Shih: Protokollin e antarësimit të Shqipërisë në OBT. W/T/ACC/ALB/53 dhe W/T/ACC/ALB/41, në faqen e Internetit të OBT-së www.wto.org

koncesioneve në situata të caktuara në bazë të disa procedurave të përcaktuara në të: Në parim ai synon të sigurojë mbrojtjen e një industrie në vendet në zhvillim, në rastet kur pretendohet se ajo ndikon në zhvillimin e ekonomisë dhe në rritjen e standartit të jetës së një vendi⁹⁰.

Së pari neni XVIII:A & C i GATT 94 parashikon mbrojtjeje për industri infante. Në mënyrë që pretendimi i një vendi të mbështetet në këto seksione ai duhet të argumentojë që kjo industri : a) është në faza të hershme të zhvillimit dhe b) ndikon në rritjen e standarteve të zhvillimit në atë vend. Për më tepër ky vend duhet të provojë, se qeveria e tij nuk mund të ndihmojë për zhvillimin e kësaj industrie, me qëllim rritjen e standartit të jetës të qytetarëve të saj dhe/ose, asnjë masë tjetër konsistente me detyrimet që rrjedhin nga GATT nuk mund të invokohet në mënyrë që të arrihet qëllimi, domethënë të mbrohet kjo industri⁹¹.

Vendi që **dëshiron** të ndë marrë një akt të tillë sipas seksionit A ose C⁹² duhet të konsultohet paraprakisht me vendet që kanë interes për këtë koncesion dhe me OBT-në, si dhe të paraqesë skemën e kompensimit, e cila në vlerë duhet të jetë e njëjtë me atë që kërkohet të mbrohet. Në qoftë se nuk arrihet asnjë marrëveshje brenda 60 ditëve, atëherë vendi që dëshiron të modifikojë apo heqë koncesionet mund ta bëjë atë, por njëkohësisht bëhet subjekt i masave kundrevepruese të lejuara nga OBT⁹³.

Seksioni B i nenit XVIII të GATT-it është përdorur më shumë në OBT. Ai i referohet bilancit të pageseve dhe për të realizuar këtë mundësi vendi kërkon kufizim në sasi të importeve (quantitative restriction) për produktet që kërkon ti mbrojë. Megjithatë mekanizmat mbrojtës të ofruar nga ky nen nuk është se kanë një mbështetje të madhe ekonomike, sepse në shumtën e rastave, kufizimet sasiore të importit nuk janë masa të përshtatshme për rimëkëmbjen e një industrie, dhe përgjithësisht mekanizmat e ofruar nga ky nen mund të zëvendësohen me masa që kanë më shumë sens ekonomik, si subvencione, investime publike, masat mbrojtëse⁹⁴. Për më tepër vendet e OBT-së janë duke depozituar propozime lidhur me paragrafet e këtij neni për sqarime të mëtejshme, si dhe për mundësinë dhe situatat konkrete kur ai mund të përdoret.

Mundësia e zbatimit të këtij neni në kushtet e Shqipërisë është e limituar, jo vetëm për arsyt ekonomike të shtjelluara më sipër, por dhe për faktin se ajo nuk është e kualifikuar si vend në zhvillim apo vend më pak i zhvilluar në kuadër të OBT-së.

5. Masat subvencionuese dhe kundërvepruese (neni XVI i GATT dhe Marrëveshja e Masave Subvencionuese dhe Kundërvepruese, SCM)

Rezultat i rëndësishëm i Raundit të Uruguajt ishte dhe Marrëveshja mbi Masat Subvencionuese dhe Kundërvepruese (më poshtë SCM⁹⁵), e cila plotësoi si nga ana

⁹⁰ WTO CTD to review provisions on economic development , Bridges Trade News , Vol 6, Nr 31, 18 Shtator, 2002

⁹¹ ibid.,

⁹² Kur kërkohet modifikim tarifash, pretendimi i një vendi mbështetet në nenin XVIII; A, dhe procedura siç dhe e përmenda është e njëjtë me atë të rinegociimit, neni XXVIII i GATT. Paragrafet e tjerë B dhe C lejojnë kufizimet sasiore si masa mbrojtëse për këtë industri.

⁹³ Neni XVIII i GATT

⁹⁴ Shih Hoekman & Kotescki, supra note 67, fq 339

⁹⁵ Agreement on Subsidies and Countervailing Measures

materiale dhe ajo procedurale nenin XVI dhe Ad nenin XVI të GATT 94 që lidhen me subvencionet. Të rejtat që solli kjo marrëveshje mund të përmbliken në :

- Jep për herë të parë përkufizimin e “ subvencioneve” dhe “ dëmtimit serioz”.
- Ndalon subvencionet e eksporteve dhe kontigjentet subvencionuese që përdoren për prodhimin vendas.
- Krijon një ide të përgjithshme për dëmtimet që sjellin disa lloje të dëmshme subvencionesh.
- Përkufizon dhe forcon procedurat për të treguar rastet kur dëmtimi është serioz në tregun e huaj.
- Përcakton një kategori të asistencës qeveritare e cila do të jetë jo –kundërvepruese në rastet dhe kushtet e caktuara nga marrëveshja.
- I kërkon vendeve në zhvillim dhe vendeve më pak të zhvilluara të paraqesin eksportet e subvencionuara dhe zëvendësuesit e importeteve të subvencionuara, dhe të përshpejtojnë paraqitjen e këtyre eksporteve, kur ky vend ka arritur të jetë konkurrues në tregjet globale për këtë kategori produkti.
- Kërkon aplikimin e sistemit të zgjidhjes së konflikteve të ofruar nga OBT-ja i cili do të ndihmojë në mos bllokimin e raporteve të Jurisë nga ato qeveri që janë duke aplikuar subvencione për eksportet⁹⁶.

Neni 1 i marrëveshjes përcakton se subvencionet realizohen kur kemi: 1) *kontribut financiar nga qeveria apo ndonjë organizëm publik brenda territorit të atij vendi*⁹⁷ dhe 2) *realizim fitimi*⁹⁸ (*confer of benefit*). Të dyja kushtet duhet të ekzistojnë përnjëherë, domethënë një grant nuk mund të quhet subvencion kur nuk realizohen fitime nga ai që e merr. Marrëveshja nuk përcakton se çfarë mund të përbëjë përfitim, por Trupi Apelit në çështjen (Kanada –Avionë Civilë)⁹⁹ përcaktoi se; *fitimi realizohet kur marrësit e subvencioneve përfitojnë në atë nivel që nuk do të ishte i realizueshëm në mungesë të këtij kontributi*¹⁰⁰.

Në kontekstin e masave kundërvepruese neni 14 i marrëveshjes SCM përcakton se kur një lloj mase jep përfitime. Gjithashtu subvencionet duhet të jenë specifike, të mbështesin një sektor apo prodhim të caktuar, sepse në rast të kundërt do të ishte e vështirë që një masë të kualifikohej në bazë të marrëveshjes. Ekzistojnë tre lloje “specifikash” të përcaktuara nga marrëveshja : Kompanitë Specifike – qeveria targeton një kompani specifike; Industri Specifike- qeveria përcakton një sektor të veçantë industrial; Rajone-specifik- qeveria subvencionon sektorë në zona të veçanta të vendit.

Marrëveshja përcakton dhe tre kategori subvencionimesh:

1) Subvencionet e ndaluara- në ligj ose në fakt, janë ato të parashikuara në nenin 3 të marrëveshjes dhe janë kryesisht ato që së pari lidhen me performancat në eksport¹⁰¹.

2) Subvencione vepruese- këtu futen ato masa që mund të kontestohen në OBT, ose janë subjekt të masave kundërvepruese¹⁰². Subvencionet në veprim nuk ndalohen

⁹⁶ Shih: Raj Bahla: “The Uruguay Round SCM Agreement”,

⁹⁷ Vetë marrëveshja parashikon një listë të llojeve të kontributeve financiare si, kredi, grante, etj

⁹⁸ Neni 1 i marrëveshjes SCM, 1994

⁹⁹ Çështja Kanada-Rregulla që prekin eksportin e avionave civilë. WT/DS70/AB/R

¹⁰⁰ Kanada- Avionë Civilë, Raporti i TA, para 157

¹⁰¹ Bashkë me marrëveshjen është dhe një liste aneks për subvencionet e ndaluara

¹⁰² Shih: “Agreement on Subsidies and Countervailing Measures (“SCM Agreement) overview” në faqen e internetit të OBT-së

shprehimisht, por bëhen subjekt padie në OBT, kur shkaktojnë efekte negative në disfavor të palës tjetër. Ka tre lloje pasojash negative: 1) Dëmtime të industrisë vendase dhe në këtë rast vendi i dëmtuar mund të përdorë masa kundërvepruese. 2) Dëmtimi serioz, zakonisht shoqërohet më zhvendosje të eksporteve, dhe mund të paditet vendi si dëmtues i interesave të eksportit për vendin tjetër. 3) Kur përkeqësohen përfitimet e realizuara nga GATT 94. Për shembull kur një rritje e aksesit të një tregu që vjen si rezultat i uljes së tarifës (në kuadër të GATT) pengohet nga subvencionet.

3) Subvencione jo vepruese-bëhet fjalë për disa subvencione të dhëna në kushte dhe situata të caktuara. Kështu në bazë të nenit 8.2 të marrëveshjes përcaktohen këto raste përjashtimore; a) asistencë qeveritare për kërkime industriale dhe aktivitete para konkurruese; b) asistencë qeveritare për zona në disavantazh; c) asistencë qeveritare për të përshtatur pajisjet dhe ambientet e punës me kërkesat për mbrojtjen e ambientit. Në këto raste nuk mund të aplikohen masat kundërvepruese.

5.1 Masat Kundërvepruese

Pjesa e V e marrëveshjes SCM parashikon se kur një vend mund të përdorë masa kundërvepruese dhe për këtë parashikohen si ana *materiale*, pra kur mund të merret një masë e tillë dhe ajo procedurale. Një vend mund të aplikojë një masë kundërvepruese vetëm kur ai arrin në përfundimin se *importet janë të subvencionuara dhe kanë shaktuar dëmtim* në prodhimin vendas. Duhet ekzistojë një *lidhje shkakësore* midis këtyre dy kushteve, sepse në të kundërt nuk mund të aplikohen masa të tilla. Kushtet për të përcaktuar nëse një produkt është i subvencionuar apo jo janë dhënë në vija të përgjithshme më sipër dhe ato pasqyrohen në pjesën e parë të marrëveshjes.

Në këtë pjesë parashikohen hapat e parë që duhet të ndërmerren dhe ato finale, si dhe koha gjatë së cilës do të zbatohet kjo masë. Këto hapa duhet të jenë transparente ku të gjitha palët e interesuar duhet të shprehin mendimin e tyre për këtë vendim, dhe autoriteti përkatës duhet të japë një shpjegim të plotë sesi ka arritur në ato rezultate.

5.2 Notifikimi

Në bazë të marrëveshjes për të dyja llojet e masave si ato të subvencioneve dhe për masat kundërvepruese, çdo anëtarë i OBT-së është i detyruar të njoftojë Komitetin e SCM. Neni 25 i marrëveshjes kërkon që të gjitha vendet anëtare të notifikojnë subvencionet e përdorura për të gjitha llojet e industrive, sektorëve dhe për subvencionet bujqësore. Notifikimet e bëra janë subjekt diskutimi dhe rishikimi në Komitetin e SCM. Nga ana tjetër neni 32.6 i marrëveshjes parashikon njoftimin për të gjitha ligjet dhe aktet e nxjerra në kuadër të masave kundërvepruese. Në këtë rast vendet duhet të njoftojë masat e para të marra, aktet finale, kohën e aplikimit të kësaj mase dhe autoritetin përkatës që merret me hetimin¹⁰³.

Ashtu si dhe në rastin e masave mbrojtëse kundra rritjes së importeve, Shqipëria nuk mund të përdorë masat kundërvepruese për produktet e subvencionuara, sepse nuk ka plotësuar kuadrin ligjor. Si edhe në rastin e parë plotësimi i ligjive është një domosdoshmëri, sepse shumë nga partnerët tanë tregtar eksportojnë produkte të subvencionuara. Plotësimi i kuadrit ligjor do ti jepte mundësinë biznesit vendas të mbrohej më mirë në kushtet e konkurrencës së pa ndershme.

¹⁰³ Shih: SCM Agreement a General Overview në faqen e internetit të OBT-së.

6. Masat Anti dumping (neni VI; 1-2, 4-6 I GATT, dhe Marrëveshja për Zbatimin e Nenit VI të GATT Antidumping Agreement ADA)

Neni VI i GATT parashikon se një dumping shkaktohet atëherë kur një eksportues shet në tregun e huaj produktin me çmim më të ulët sesa vlera e vetë produktit. Pra në vija të përgjithshme kjo praktikë ndodh atëherë kur çmimi me të cilin prodhuesi e eksporton mallin, është më i ulët se ai i ofruar në vendin e tij¹⁰⁴. Diferenca midis çmimit vendas dhe atij në tregun e huaj quhet zakonisht si "Përqindja (margin) i dumpi-t. Pra formula e përdorur për të llogaritur përqindjen është :

$$\text{Përqindja e Dumpit}^{105} = \frac{\text{Vlera normale} - \text{çmimin e eksporti}}{\text{Çmimin e Eksporti}} \times 100$$

Disiplina e ofruar nga GATT për dumping u plotësua nga Kodi i negocuar në Raundin e Kenedit. Marrëveshja e Anti Dumping-ut,(më poshtë ADA) u përfundua në Raundin e Uruguajit, dhe u bë pjesë e Paketës së Vetme të ofruar nga ky Raund.

ADA, ofron më shumë detaje dhe rregulla për të gjithë procedurat e anti dumping-ut, që nga hetimi dhe vërtetimi që ai ekziston, dhe deri te marrja e masave kundravepruese për të mbrojtur prodhimin vendas dhe për të eliminuar tregtinë e pandershme¹⁰⁶.

Ashtu si marrëveshja për SCM, dhe ADA përbëhet nga nene materiale dhe procedurale. Së pari, neni 2 i marrëveshjes përcakton kalkulimin e dumpit, sipas formulës të cilën e shpjeguem më sipër. Kjo formulë parashikon një llogaritje standarte të dumpingut, ndërkohë që neni 2.2 i ADA-s parashikon dhe mënyrat alternative të llogaritjes së dumpingut. Këto mënyra përdoren në rastet kur në situatat e zakonshme të tregtisë nuk ka shitje të produktit në tregun e vendit eksportues, atëherë krahasimi bëhet me çmimin e eksportit në një vend të tretë, duke provuar se çmimi i eksportit përfshin vlerën e mallit plus koston administrative të shtitjes. Më tej jepen rregullat në bazë të të cilave do të përcaktohet dëmtimi material. Është e rëndësishme të vërtetohet edhe në këtë rast, ashtu si dhe në rastin SCM, se ekziston një lidhje shkakësore midis dumpit dhe dëmtimit të një industrie nga ky dump¹⁰⁷.

Përcaktimi se kush përbën industri vendase është një element i rëndësishëm i përcaktuar nga marrëveshja. Kështu neni 4 i ADA klasifikon si "industri vendase" atë industri që prodhon "produkte të ngjashme"¹⁰⁸ me ato që janë importuar dhe janë dump.

Lidhur me pjesën procedurale, si kërkesë kryesore marrëveshja ka parashikuar ekzistencën e transparencës, domethenë të gjitha hetimet dhe masat duhet të bëhen në

¹⁰⁴ Në këtë rast çmimi i shtitjes në tregun e vendit është i barabartë me vlerën e produktit

¹⁰⁵ Në qoftë se vlera e formulës është pozitive atëherë dumpi është realizur në qoftë se është negative ose zero atëherë nuk kemi dump. Vlera zero është e diskutueshme sepse ajo llogaritet nga mesatarja e shkëmbimeve tregtare. Në rast se vetëm një nga shkëmbimet tregtare ka qenë dump, atëherë ndodhemi në kushtet e hetimit të mëtejshme për ta vërtetuar atë. Kjo njihet si "zeroing problem" dhe është pjesë e debateve në kuadër të marrëveshjes.

¹⁰⁶ Shih: John Jackson "World Trading System", Botim i Dytë 2002, fq 247-274

¹⁰⁷ Neni 3 i ADA parashikon faktorët që duhen të kihen parasysh në përcaktimin e dëmtimit dhe paragrafi 5 kërkon ekzistencën e lidhjes që duhet të realizohet nga dy elementet.

¹⁰⁸ Produkte të ngjashme janë ato produkte që kanë karakteristika të përbashkëta dhe mund të zëvendësojnë njëra tjetrën.

mënyre transparente. Hetimi mund të nisë me anë të një peticioni të prodhueseve të dëmtuar dhe veprimet e mëtejshme realizohen nga një autoritet publik i specializuar. Të gjitha rregullat e investigimit janë përcaktuar në marrëveshje. Për shembull hetimi nuk mund të zgjasë më shumë se 18 muaj që nga data e nisjes së tij.

Neni 9 i marrëveshjes përcakton dhe masat që merr vendi industria e të cilit është dëmtuar nga produktet dump dhe rregullat sesi duhet të kompensohet ajo. Në këtë rast vendoset një taksë doganore, vlera e së cilës duhet të jetë pak më e ulët se përqindja e dumpit¹⁰⁹. Një masë tjetër është ajo e sipërmarrjes së çmimit nga vetë eksportuesit të cilët e rrisin atë (çmimin) në mënyrë që të eliminojnë dëmin e produktit vendas¹¹⁰. Një nga arritjet e marrëveshjes është dhe e ashtuquajtura klauzola "sunset" (neni 11 i ADA-s), e cila parashikon mundësinë e rishikimit të masave kundra dumping-ut brenda 5 vjetëve që nga data e aplikimit të tyre.

Njoftimi i vazhdueshëm i masave të marra në kuadër të anti dumping-ut dhe aplikimi i tyre, duhet t'u bëhen të njohura paraprakisht Komitetit të praktikave të Antidumpingut në OBT.

Marrëveshja ADA është një nga marrëveshjet e invokuara gjerësisht në mekanizmat e zgjidhjes së konfliktit në OBT, dhe nenet e saj janë sqaruar dhe elaboruar më tej nga Juria dhe Trupi i Apelit¹¹¹.

Kuvendi Shqipërisë ka miratuar ligjin për Antidumpingun dhe ky i fundit është një pasqyrues i neneve të marrëveshjes. Megjithatë zbatimi i tij kërkon një kuptim më të mirë të vetë ligjit, si dhe një bashkëpunim më të madh midis grupeve të biznesit dhe autoritetit publik, për të zhvilluar hetimet, në mënyrë që të eliminohen dëmtimet që i shkaktohen biznesit vendas nga importet dump.

Konkluzione

Nxjtja e tregtisë së lirë, harmonizimi i politikave tregtare dhe ruajtja e balanceve në zhvillimet ekonomike deri në zbutjen e varfërisë globale, përbëjnë sot prerogativat e Organizatës Botërore të Tregtisë. Kjo e fundit u konceptua jo vetëm për të sanksionuar parimet dhe kushtet në të cilat do të realizoheshin këto qëllime, por dhe për të ofruar mekanizmat e përshtashme për arritjen e tyre. Organet e krijuara në këtë organizatë realizojnë pjesmarrjen e vendeve anëtarë në bërjen e politikave globale, megjithatë mbetet e kontestuar mundësia e imponimit të vendeve në zhvillim dhe pak të zhvilluara në këtë vendim-marrje. Shpesh ky proces kthehet në një shesh debatesh të nxehta dhe përplasje interesash.

Mekanizmi i zgjidhjes së konflikteve është një tjetër mundësi që siguron parashikueshmëri të marrëdhënieve tregtare dhe realizim të të drejtave dhe detyrimeve për të gjitha palët në marrëveshje. Ndonëse roli i tij sot limitohet në kërkesën dhe detyrimin për përpunueshmëri, fakti që një numër i madh çështjesh shkon në Trupat e Zgjidhjes së Konfliktit, tregon që ky mekanizëm funksionon dhe shënon një arritje për marrëdhëniet tregtare ndërkombëtare. OBT-ja përfshin një mori fushash, të cilat e bëjnë dhe më kompleks spektër të saj të veprimit. Nën ombrellën e saj synohet të kristalizohen gjithmonë e më shumë fusha të cilat janë të lidhura me liberalizimin e tregut.

¹⁰⁹ Shih paragrafin 3 të nenit 9 të ADA.

¹¹⁰ Shih Neni 8 i marrëveshjes

¹¹¹ Shih për më shumë: Marrëveshja për zbatimin e nenit VI të GATT, një vështrim i përgjithshëm, në faqen e internetit të OBT-së, www.wto.org

Shqipëria, nëpërmjet anëtarësimit në OBT, krijon më shumë mundësi për zhvillimin e një ekonomie në përputhje me rregullat dhe standartet ndërkombëtare. Në kuadër të antarësimit ajo ka ndërmarrë një sërë angazhimesh, të cilat prekin fusha me rëndësi të madhe ekonomike, ndaj dhe shpesh politikat tregtare shoqërohen me debate dhe përpjekje të të gjitha grupeve të interesit për të ruajtur balancat ndërmjet liberalizimit të tregtisë dhe fuqizimit të biznesit vendas. Pavarësisht nga vështirësitë, pjesëmarrja në OBT, mbetet një kusht i domosdoshëm, për mbizotërimin e rregullit dhe ligjit në marrëdhëniet tregtare, kusht i cili ndikon drejtpërsëdrejti në zhvillimin ekonomik të vendit .

Të gjitha veprimet që bien ndesh me këtë parim përbëjnë shkelje të hapur të neneve të marrëveshjeve të saj. Ndaj për të mbajtur në ekuilibër të vazhdueshëm, interesat e gupeve të ndryshme dhe zhvillimet e pa-parashikura të tregtisë, vendet anëtare të OBT-së kanë lejuar klauozala të veçanta që përdoren për të mbrojtur industritë vendase. Duhet theksuar dhe njëhërë se aplikimi i tyre duhet bërë vetëm kur plotësohen kushtet e parashkuara në ligj, pra në marrëveshjet e OBT-së, dhe vetëm në bazë të procedurave përkatëse. Në çdo rast përdorimi, kërkohet ruatje e reciprocitetit dhe e balancave liberalizuese të cilat realizohen, si nëpërmjet detyrimit për kompensim, ashtu edhe nëpërmjet vendosjes së afateve dhe mundësisë për rivlersim të masave mbrojtëse dhe kushteve që i diktuan ato.

Mbrojtja e industrive vendase nga rritja e importit realizohet nga nenet që lejojnë rinegociim të tarifave dhe zbatimin e masave mbrojtëse, kur vërtetohet se importet rriten deri në dëmtim të prodhimit vendas. Për të dyja mekanizmat duhet ofruar skemë kompensuese për partnerët në tregti.

Një grup tjetër masash mbrojtëse i referohet rasteve kur kemi të bëjmë me tregti të pandershme si importe dump apo të subvencionuara. Në këto rast nuk kërkohet kompensim, por një transparencë në vendosjen e masave kundërvepruese dhe niveli i mbrojtjes nuk duhet të jetë më i madh se niveli i dëmit të shkaktuar.

Marrëveshjet e OBT-së dhe Trupat e zgjidhjes së konfliktit kanë ofruar një fushë zbatimi dhe konsolidimi të këtyre mekanizmave. Çështjet e ardhura në OBT në bazë të këtyre neneve kanë ndihmuar në kuptimin me të mirë të detyrimeve dhe të drejtave që lidhen me to.

Në kushtet e Shqipërisë vihet re një vështirësi e mundësisë së kualifikimit të situatave konkrete, domethënë mundësisë për mbrojtje në hapësirat ligjore të ofruara nga marrëveshjet, sepse në të shumtën e rasteve mungon legjislacioni përkatës, ose nuk ka një artikullim të mirë të pretendimeve nga biznesi vendas. Ndaj bashkëpunimi midis grupeve të interesit, (Qeveri –Biznes), për të plotësuar kuadrin ligjor dhe për të ruajtur konformitetin me ligjet e OBT-së, është e vetmja rrugë për të shmangur konfliktet dhe për të forcuar ekonominë e tregut.

